

ISH-TE PERNDJEKURIT, NIS PAGESA PER ATA QE JANE GJALLE DHE TRASHGIMTARET

Dëmshpërblimi i ish të përndjekurve politik deri tani ka ngecur. Ministria e Financave: Shkak vonesa e dokumentave

DRICIM ÇAKA



[SHQIPTARJA.com]

Lexoni
Dëgjoni
Shikoni
EDICIONI MULTIMEDIAL



Kjo gazetë përdor teknologjinë QR-CODE

ÇMIMI 30 LEKË

VITI VI - NR. 170

E MËRKURË, 20-07-2016

www.shqiptarja.com

AMNISTIA

KUJT I 'FSHIHEN' DETYRIMET DHE GJOBAT E MAKINAVE

Gjobat, taksat, qeveria sot merr në analizë projektligjin e përgatitur nga Financat

▶ F13

THIRRJE PUBLIKE



ZEF BROZI: VOTONI PER SHQIPERINE JO PER SALINE


Ish-kreu i Gjykatës së Kasacionit u bën thirrje publike deputetëve të PD për të votuar reformën në drejtësi

▶ F6

"Lista e zezë" e SHBA JA SANKSIONET PER DEPUTETET E PABINDUR



Ndëshkimi amerikan për ata që nuk votojnë Reformë në Drejtësi, nga bllokimi i llogarive bankare e pronave dhe refuzimi i vizave. Lu në protestë kundër PD: Kush voton kundër, armik i Amerikës



RAMA I UNIFIKUAR ME METEN: ALEANCA JONE DO TE VOTOJE NE BLOK "PRO". TERHIQET BASHA JEP SINJALIN E KONSENSUSIT: PRANOJ PROPOZIMIN HIBRID



ESIONA KONOMI

▶ FAQE 2-5

KORRUPSIONI

▶ F11

HETIM PASURISE SE GJYQTARES MAJLINDA ANDREA

GRABITJA

▶ F9

ZBARDHEN PAMJET FILMIKE SE SI U VODH BANKA NE VLORE

DOKUMENTI I VITIT '41

▶ F18-19

"EPIRI NUK KA QENE KURRE GREK", JA ARGUMENTET



INTERVISTA

▶ F7

PEZA: KUSH S'EVOTON REFORMEN BEN VETEVASJE POLITIKE

"Lista e zezë" e SHBA, ja sanksionet për deputetët e pabindur

Ndëshkimi amerikan, nga bllokimi i llogarive bankare e pronave dhe refuzimi i vizave

ESIONA KONOMI
TIRANE

Ambasadori amerikan Donald Lu foli dje, në protestën e Shoqërisë Civile, për miratimin e reformës në drejtësi, se deputetët të cilët do votojnë kundër reformës në drejtësi, do ndeshen me masa ndëshkuese nga SHBA. "Do të ketë pasojë specifike negative nga Shtetet e Bashkuara për ata udhëheqës politikë që do të votojnë kundër kësaj reforme. Unë jam duke u dorëzuar partive politike hollësisht mbi këto pasojë sipas udhëzimeve specifike nga Uashingtoni. Unë siguroj se këto pasojë do të jenë të rënda dhe afatgjata", u shpreh ambasadori Lu, duke folur për herë të parë për masa ndëshkuese nga SHBA ndaj deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, në rast se vota e tyre të enjten në orën 10 do jetë kundër draftit hibrid të reformës në drejtësi. Si vendosen këto sanksione? Kongresi amerikan apo Shtëpia e Bardhë

PENALIZIMET AMERIKANE	
1.	Pengimi i lëvizjes së lirë dhe refuzimi i vizave për personat në listën e zezë
2.	Blokimi i marrëdhënieve të personave me njollë me çdo zyrtar amerikan të çdo niveli
3.	Refuzim i mundësisë së shkëmbimit tregtar apo të marrëveshjeve të biznesit mes personave të kufizuar dhe shtetasve amerikanë
4.	Ngrirja e llogarive bankare personale apo të kompanive në pronësi të këtyre personave
5.	Blokimi i pasurive të paluajshme që këta persona mund të kenë në SHBA
6.	Ngrirja e asetëve dhe bllokimi i licencimit për kompanitë ku janë të përfshirë këta persona
7.	Aleanca me shtete apo unione të tjera për të shtrirë të njëjtat sanksione. P.sh. SHBA mund të dakordësojë me Bashkimin Evropian për të unifikuar sanksionet

kanë cdo vit një listë që ata e quajnë "lista e zezë" e cila rinfreskohet vazhdimisht dhe në të përfshihen emra individësh, politikanësh apo biznesmenësh, si dhe kompani të ndryshme. Për çdo kategori, Shtëpia e Bardhë nxjerr një dokument, që quhet

kumtesë, dhe përcakton sanksionet për çdo kategori. Po cilat janë disa nga pasojat që do rëndojnë mbi ligvënësit shqiptarë? Mekanizmi ndëshkues i SHBA-së ndaj personave apo individëve të veçantë është ai i futjes në "listën e zezë", që do të thotë ndalimi



i hyrjes në SHBA dhe jo vetëm. Kjo pasi, nisur nga marrëveshjet e SHBA-ve me Bashkimin Evropian, pasojat mund të shtrihen edhe në shtrihen edhe drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Pra, nëse një deputet përfundon në "listën e zezë" të SHBA, atij mund t'i hiqet e drejta e udhëtimit edhe drejt vendeve të BE. Pengimi i lëvizjes së lirë dhe refuzimi i vizave për personat në listën e zezë është vetëm një nga pikat kryesore dhe fillatare të sanksioneve. Bllokimi i marrëdhënieve të personave me njollë me çdo zyrtar amerikan të çdo niveli është një tjetër sanksion që mund të izoltojë karrierën e një politikani. Për deputetët që merren edhe me biznes, sanksion i rëndësishëm është refuzimi i mundësisë së shkëmbimit tregtar apo të marrëveshjeve

të biznesit mes personave të kufizuar dhe shtetasve amerikanë. Po ashtu, deputetët rrezikohen nga ngrirja e llogarive bankare personale apo të kompanive në pronësi të këtyre personave, shoqëruar edhe me një sanksion tjetër rëndësues që është bllokimi i pasurive të paluajshme që këta persona mund të kenë në SHBA. Në kategoritë e sanksioneve, përfshihet dhe ngrirja e asetëve dhe bllokimi i licencimit për kompanitë ku janë të përfshirë këta persona. Ajo që duket më e rënda dhe e rrezikshme të paktën për deputetët tanë, është një aleancë e mundshme e SHBA-së me shtete apo unione të tjera për të shtrirë të njëjtat sanksione. P.sh. SHBA mund të dakordësojë me Bashkimin Evropian për të unifikuar sanksionet e mësipërme.

DRAFTI

Doda e vendos kusht, tërhiqet propozimi për martesat gay

"Falënderoj me këtë rast gjithë kolegët tanë deputetë që u bashkuan në kauzën Pro Familjes Natyrale"



ishte procedurale për të përgatitur raportin që do t'i përcillet seancës. Për t'i hapur rrugë shqyrtimit të rendit të ditës. Kemi shqyrtuar edhe disa ndryshime që janë pjesë e projektit, duke hequr një pjesë të neneve që nga grupet parlamentare, janë konsideruar si dispozita që janë jo të lidhura drejtpërdrejtë për detyrën dhe mandatin e komisionit të posaçëm parlamentar. Janë nene që kanë të bëjnë me BE dhe dispozita të tjera. Kemi reflektuar edhe progresin e deritanishëm, formulën hibride, në mënyrë që kjo pjesë të jetë e përgatitur për shqyrtim dhe votim në seancë plenare", u shpreh Xhafaj. Lidhur me këtë vendim të komisionit të reformës, ka reaguar deputetja e PDIU, Mesila Doda e cila e quajti lajm të mirë heqjen e nenit për martesat gay nga drafti i reformës në drejtësi. "Me kërkesën e PDIU dhe këmbënguljen

tone pa kompromis, sot u shfuqizua nga Komisioni i Posaçëm i Reformës ndryshimi Kushtetues që i hapte rrugë legalizimit të martesave gay. Kjo do të thotë se së bashku arritëm të ndalnim një ndryshim që mund të sillte një strukturë tjetër sociale, larg modelit të familjes natyrale e tradicionale. Falënderoj me këtë rast gjithë kolegët tanë deputetë që u bashkuan në kauzën Pro Familjes Natyrale, kërret e religjioneve dhe besimtare, familjaret, të rinjtë e të rejtat që konsiderojnë modelin tonë familjar atë burrë-grua dhe që përkrähën këtë vizion të shëndetshëm të shoqërisë sonë", shkruan në Facebook, Mesila Doda.

REFORMA

Takimi Rama-Ildrizi kreu i PDIU: Të mos votohet pa konsensus

Pas deklaratës se Reforma në Drejtësi do 94 vota që të miratohet kryeministri Rama ka takuar mëngjesin e djeshëm dy deputetë të PDIU-së, partisë aleate e PS. Në takimin mori pjesë kreu i kësaj force politike Shpëtim Idrizi dhe deputeti Aqif Rakipi. Rreth orës 09:35 kryeministri Rama ka dalë nga ambientet e hotelit aty ku po konsumonte kafën e mëngjesit me aleatin e tij Idrizin dhe iu drejtua në këmbë kryeministrisë, pa dashur të bëjë komente për median. Pas takimit me kryeministrin Rama kreu i PDIU-së u shpreh se nëse nuk arrihet kompromisi, atëherë propozimi i PDIU është që populli të vendosë me referendum. "Shumë mirë që arrihet shqiptarë të takohen dhe të gjejnë një kompromis. Kjo tryezë liderësh ka prodhuar një tryezë ekspertësh, dhe besoj se do të arrihet kompromisi dhe të enjten t'i jepet shqiptarëve ajo gjë e gmuar, që është reforma në drejtësi. Ne jemi fokusuar në dy ditët e mbetura që të gjendet rruga



për të realizuar reformën në drejtësi. Tashmë po kërkohet kompromisi për nenin 88. Në rast se forcat politike nuk e gjejnë kompromisin për këtë pikë, ne jemi që t'i drejtohem popullit për referendum", tha deputeti Idrizi. Dy natë më parë kryeministri Rama mbledhi ministrat e kabinetit me të cilët diskutoi për hapat që do ndërmerren për miratimin e reformës. Rama u shpreh në konferencën për

shtyp, pas takimit tregalësh për reformën në drejtësi, se 21 korriku duhet të jetë dita e bashkimit që do t'i çelë rrugë një revolucioni të mirëfilltë dhe transformimi të madh të Shqipërisë. Duke e konsideruar reformën në drejtësi një revolucion të pashmangshëm, shefi i mazhorancës u shpreh i bindur se paketa e ndryshimeve Kushtetuese do të miratohet në 21 Korrik dhe për të do të shkojnë 94 vota.



Lu në protestë kundër PD: Kush voton kundër, armik i Amerikës

ESIONA KONOMI
TIRANE

Ambasadori amerikan ka bërë dje lëvizjen e fundit, më pak diplomatiken që mund të bëjë një ambasador, me gjasë i gjendur pa asnjë armë tjetër bindëse për politikën shqiptare. Ai ka kërcënuar të gjithë ata deputetë që nuk do të votojnë Reformën në Drejtësi të enjten, duke ju bërë me dije se do të ketë pasoja të rënda e afatgjata

Ambasadori i SHBA: Kush nuk voton do të ketë pasoja të rënda dhe afatgjata nga SHBA-të



Pasojat

"Do të ketë pasoja specifike negative nga Shtetet e Bashkuara për ata udhëheqës politikë që do të votojnë kundër kësaj reforme. Ju siguroj se këto pasoja do të jenë të rënda dhe afatgjata."

që vijnë drejtpërdrejt nga SHBA. "Qytetarët po kërkojnë ndryshim. Pushtetarët kanë frikë. Unë po i dorëzoj partive politike udhëzimet mbi këto pasoja që çojnë direkt nga Uashingtoni por

i siguroj se janë të rënda dhe afatgjata" -tha Lu para qytetarëve para Kryesisë së Kuvendit. Këto deklarata ambasadori i bëri teksa mori pjesë në një protestë civile e cila i drejtohet opozitës dhe i kërkonte miratimin e reformës. Kjo është dita e dytë e protestës shoqërisë civile ku kërkojnë me ngulm miratimin e reformës ditën e enjte ndërkohë që edhe për sot dhe të enjten shoqëria civile ka njoftuar një tjetër proteste po me të njëjtën temë. Kujtojmë se më 21 korrik është vendimtare nëse reforma votohet apo jo në Parlament.

nga këta politikanë nuk duan marrëveshje. Dy javë më parë, dëgjova me zë të fortë nga Basha dhe Bylykbashi se nëse e zgjidhnim paragrafin

88, ata do ta votonin reformën që të nesërmen. Më 9 korrik e zgjidhëm paragrafin 88. Në fund, Rama u dorëzua dhe u ofroi atyre saktësisht atë që Basha kishte kërkuar, një proces përzgjedhjeje të quajtur 6 plus 6. Por kjo nuk mjaftonte. Tani, për herë të parë, ata thonë se për shkak të sovranitetit kombëtar, nuk mund të pranojnë që të huajt të bëjnë vlerësimet për kualifikimet e komisionerëve. Epo kjo është e çuditshme. Më 19 maj Basha na tha ne dhe Ambasadores Vlahutin se të huajt ishin të vetmit persona që mund ta pastronin peshkun nga koka. U tha të njëjtën gjë edhe deputetëve të PE-së, Kukan dhe Fleckenstein. Bylykbashi e përfshiu këtë në mënyrë të qartë në propozimin e tij zyrtar, të shkruar, që na dërgoi. Tani papritur po ndryshojnë qëndrimin e tyre. Përse? Njerëz të fuqishëm kanë frikë. Qytetarët po kërkojnë ndryshim. Është koha për të vendosur. Do të ketë pasoja specifike negative nga Shtetet e Bashkuara për ata udhëheqës politikë që do të votojnë kundër kësaj reforme. Unë jam duke u dorëzuar partive politike hollesitë mbi këtë pasoja sipas udhëzimeve specifike nga Uashingtoni. Ju siguroj se këto pasoja do të jenë të rënda dhe afatgjata. Gjatë ditëve të fundit jam takuar me dhjetëra deputetë, nga të gjitha partitë politike. Jam i bindur se këta persona i kanë për zemër interesat më të mira të Shqipërisë. Të gjithë e duan këtë reformë. Pyetja është nëse do të kenë kurajon të votojnë për atë që e dinë se është e gjëja e duhur për Shqipërinë, apo do të votojnë për shkak të frikës nga udhëheqësit e partive të tyre politike. Shqipëria u themelua më shumë se 100 vite më parë nga burra dhe gra të guximshëm. Burra si Ismail Qemali rrezikonin jetën e tyre për pavarësinë e këtij vendi. Është përsëri koha t'u kërkohe shqiptarëve kurajo dhe besim për të bërë atë që është e drejtë. Koha për të vendosur është tani. Miratojini këtë reformë!

LU NË PROTESTË

E surprizojnë me këngë polifonike për SHBA e reformën

Ambasadori amerikan Donald Lu i është bashkangjitur protestës së qytetarëve para Kuvendit për kalimin e reformës në drejtësi, duke i dhënë një tjetër përmasë rolit të tij të rëndësishëm në këtë hap të Shqipërisë. Lu ka paralajmëruar drejtpërdrejt dhe ashpër partitë politike shqiptare, e kryesisht opozitën, se zvarritja e kësaj reforme do të sjellë pasoja të rënda. Me gjithë përpjekjet e shumëllojshme të Lu-së politikanët shqiptarë vijnë të zvarrisin reformën, pa mundur të sjellin miratimin që populli shqiptar dhe ndërkombëtarët e kërkojnë me aq shumë ngulm. Ndërkohë që Lu bëri lëvizjen e fundit që reforma të kalojë duke protestuar së bashku me qytetarët, ai ka marrë si surprizë një këngë polifonike që i kushtohet Shteteve të Bashkuara dhe reformës në drejtësi.



Për të parë videon në smartphon tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

FJALA E PLOTË E LU

Dje, pas takimit të shkurtër midis Z. Rama, Z. Meta dhe Z. Basha, ekspertët tanë u takuan për 8 orë negociatash deri në orën 2 të mëngjesit. Por nuk arritën dot një marrëveshje. Pas 18 muajsh negociatave, pse nuk arrimim kurrë një marrëveshje? Pse? Për shkak se është e qartë se disa

PE diskuton Reformën, Hahn: Nëse s'kalon, duhet referendum

Eurodeputetët: Hapja e negociatave lidhet drejtpërdrejt me drejtësinë

Komiteti i Politikës së Jashtme të Parlamentit Evropian (AFET) ka diskutuar dje për Reformën në Drejtësi. Në fjalën e tij të hapjes komisioneri Hahn ka theksuar qartësisht se Shqipëria është shumë afër konsensusit. Ai theksoi se nëse të enjten në Kuvend nuk ka një miratim të Reformës e një konsensus mes palëve atëherë duhet një Referendum pasi populli e do këtë Reformë. "E nevojshme që reforma të miratohet me konsensus. Jemi përpjekur të kuptoj se çfarë është arritur në takimin e djeshëm. Pas miratimit të nis menjëherë zbatimin e reformës. Jemi shumë afër marrëveshjes sa

Eurodeputeti

"Jemi shumë afër marrëveshjes sa i përket procesit të vettingut. Nëse nuk arrihet miratimi i Reformës, mund të ketë Referendum Nëse nuk arrihet miratimi i Reformës, në pikëpyetje integrimi në BE"

i përket procesit të vettingut. Nëse nuk arrihet miratimi i reformës, mund të ketë referendum. Nëse nuk arrihet miratimi i reformës, në pikëpyetje integrimi në BE. Më 21 korrik duhet të arrihet me patjetër një marrëveshje"-u shpreh ai. Nga ana tjetër, Eurokomisioneri Brok tha

se ende asgjë nuk është e sigurt për reformën, ndonëse janë zhvilluar bisedime me të gjithë aktorët politikë. "Ka theksuar se reforma në drejtësi është shumë e rëndësishme për zhvillimin e negociatave Shqipërinë-BE. Vitin e ardhshëm do të ketë zgjedhje në Shqipëri, por

ka patur hezitime sa i takon reformën në gjyqësor. Pas 21 korrikut do të shohim sesi do të vazhdojnë zhvillimet. Nëse nuk do të vonohet reforma në drejtësi, besojmë se nuk do të mund të vonohemi më lidhur me këtë çështje. Janë zhvilluar bisedime me partitë në koalicion, me liderin e opozitës, me ambasadorët e SHBA e BE, është biseduar me presidentin. Duket sikur është arritur një kompromis, por asgjë nuk është ende e sigurt. Komisioneri Hahn është përgjegjës për këtë. Kemi përcjellë një mesazh të veçantë, dhe besojmë se do të arrihet në një marrëveshje"-tha Brok. "Politikanët shqiptarë nuk janë shumë të sigurt sa i përket imunitetit të tyre, dhe ndaj po bëhet e gjitha kjo, gjithë kjo vështirësi, sa i përket miratimit të reformës. Duhet kuptuar edhe pala shqiptare se është vërtet një çështje e rëndësishme. Ne po ju dërgojmë një sinjal mjaft të rëndësishëm, fakti që ne po e diskutojmë është shumë domethënëse"-tha Tanja Fajon.



Rama i unifikuar me Metën: Aleanca jonë do të votojë në bllok "Pro"

Kryeministri: Jam i hapur për konsensus të pranuar deri të enjten në orën 10

ESIONA KONOMI
TIRANE

Pavarësisht tezave politike të artikuluar pas propozimit të Metës për një qeveri ekspertësh dhe zgjedhje të parakohshme, koalicioni qeverisës duket se nuk ka asnjë ndasi sa i takon votës për reformën në drejtësi për ditën e nesërme. Kryeministri Edi Rama në një dalje për mediat, kësaj radhe foli në emër të koalicioni qeverisës, "Aleanca për Shqipërinë Europiane", dhe jo vetëm të grupit parlamentar të PS-së. Ai tha se ASHE do të votojë në bllok për reformën në drejtësi. Ai theksoi se mazhoranca i ka votat për ta kaluar reformën ditën e enjte. "Aleanca për Shqipërinë Europiane" do të votojë në bllok për ta çuar faqebardhë vendin dhe popullin tonë në derën e negociatave për anëtarësim në BE. "Aleanca për Shqipërinë Europiane" do të votojë në bllok, për të mbrojtur dritën e të ardhmes për gjeneratën tjetër", u shpreh Rama. Shefi i mazhorancës theksoi sërisht se opozita është e mirëpritur për konsensus deri të enjten në orën 10:00, ndërsa kujtoi se e vetmja mundësi për dakordësi është drafti hibrid i propozuar nga Ndihmës Sekretarja Amerikane e Shtetit, Victoria Nuland. "Kam qenë, jam dhe do të jem, deri në orën 10:00 të datës 21 korrik, i gatshëm për konsensus. Propozimi hibrid i paraqitur nga Nuland është e vetmja mundësi për konsensusin parlamentar të 21 korrikut. E rikonfirmoj se deri në ora 10:00 të 21 korrikut, gatishmëria për të gjetur zgjidhje për këtë propozim, tashmë është e plotë. Ne 140 deputetët e Kuvendit të Shqipërisë është shumë e qartë, ose të votojmë në emër të Shqipërisë, dhe njerëzve të këtij vendi, për të shpëtuar nga kthetrat e atyre që kanë marrë peng këtë vend, ose të veprojmë sipas frikës duke lejuar këtë pengmarrje shekullore, ose të votojmë faqebardhë për të mundësuar çeljen e negociatave e të ulemi në tryezën e BE, ose ta votojmë për faqen e zezë



Ftesa

"Kjo seancë plenare nuk do të përmbyllet pa miratimin e kësaj Kushtetute të re dhe në këtë frymë përgjegjshmërie e serioziteti ftoj të jenë të pranishëm të gjithë përfaqësuesit ndërkombëtarë të përfshirë në procesin parapërgatitor të reformës në drejtësi".

Fshirja e emrave

E drejta e vëzhguesve ndërkombëtarë pjesë e vettingut, për të fshirë nga lista e kandidatëve emra të cilët nuk i vlerësojnë si të përshtatshëm. Opozita e konteston këtë pikë.

ÇËSHTJET PEZULL

kundër SHBA e BE e ta bëjmë Shqipërinë vendin që do damkoset se refuzoi reformën strategjike për pastrimin e drejtësisë nga plehurat e korrupsionit. Ose të votojmë me konsensus të

"Do të votohet me konsensus, Rama është më konstruktivi"

Nesër votimi, kreu i Kuvendit: S'dalim nga salla pa e miratuar reformën

Nesër do të jetë "e enjta e madhe" e politikës shqiptare, ku 140 ligjvënës do të duhet të votojnë për një Kushtetutë të re, që parashikohet të përbëjë një ndër reformave më të thella të ndërmarrja gjatë pluralizmit politik. Reforma në drejtësi do të jetë pika e parë e rendit të ditës të punimeve të Kuvendit, më 21 Korrikut në një seancë që pritet të jetë maratonë, por edhe surprizuese për mënyrën se si do të ndahen kartonat. Kryeparlamentari Ilir Meta u shpreh dhe se Kuvendi ka miratuar rendin e ditës për seancën dhe paketa e ndryshimeve kushtetuese është pika e parë. "Seanca e Kuvendit do të jetë solemne që do t'i japë vendit dinjitetin e duhur përpara BE, përpara NATO, përpara SHBA dhe gjithë

partnerëve të tjerë. Kjo është seanca më e rëndësishme e punimeve të Kuvendit, ndoshta që nga dita kur u votua Kushtetua e vendit tonë, sepse na duhet të votojmë me konsensus ndryshimet kushtetuese të cilat përbëjnë një kushtetutë tashmë të re, të cilat strukturojnë drejtësinë e dekadave të ardhshme. Kjo seancë nuk do të mbyllet pa miratuar Kushtetutën e re", u shpreh Meta. Kreu i Kuvendit kërkoi që tryeza e negociatorëve ta përmbyllë me shpejtësi draftin e për-bashkët. "Ekspertët negociatorë janë të mandatuar të ushqejnë qëndrimeve konsensuale mbështetur vetëm në propozimin hibrid të Ndihmës Sekretares Amerikane të Shtetit, Victoria Nuland, që ka mbështetur SHBA dhe BE. E ftoj

këtë tryezë të vazhdojë punën dhe ajo që unë kërkoi si kryetar i Kuvendit, është që diskutimet tashmë t'i bëjë të hapura e transparente për mediat e qytetarët shqiptarë. Deputetët të enjten në orën 10:00, në 21 korrik dhe opinionin publik shqiptar, kanë nevojë të njihen me përmbajtjen e këtyre diskutimeve si dhe vendimmarrjen e tyre. Populizmi nuk është transparencë", deklaroi Meta. Më herët, kreu i Kuvendit, pati një takim me Lulzim Bashën, në përfundim të së cilës ai tha se ditën e enjte Kuvendi do të miratojë me konsensus reformën. Pas asaj që u duk një thyerje e fortë mes tyre, Meta dhe vlerësoi kryeministrin Rama se: "Kryeministri është më konstruktivi nga të gjithë në katër aktoret e tjerë", tha Meta.

Ankimimi në Kushtetuese

PD kërkon që Gjykata Kushtetuese të ketë të drejtën dhe detyrimin të shqyrtojë të gjitha ankimimet e aplikantëve të skualifikuar nga vetë ndërkombëtarët përfaqësues të SHBA dhe BE.

gjithë së bashku, ose të ndahemi në mbrojtës të dritës, e të errësirës", deklaroi Rama. Ai tha se mazhoranca nuk mund t'i plotësojë kërkesën PD-së, për tu rreshtuar në një front kundër

SHBA-së, ndërsa i bëri thirrje kryetarit të PD, Lulzim Basha, që të sillt si lider. "I bëj thirrje kryetarit të Partisë Demokratike që të sillt si lider, se ka mbi supë përgjegjësinë e një

barre, nga ato që historia nuk i sjell përditë në udhëheqjen e një opozite. I kemi plotësuar opozitës kërkesën themelore për barazi të plotë në realizimin e reformës, por nuk mund t'ia plotësojmë dot kërkesën për tu bashkuar në një front kundër SHBA-së. "Vija e kuqe" e tyre është vija mbrojtëse për Shqipërinë e shqiptarët, e cila garanton shpeshën mbi të korruptuarit në sistemin e drejtësisë. PD ka fituar në këtë proces të gjithë atë që i takon, dhe singlerisht e komplotoj Lulzim Bashën për rrekjen e tij për gjithë atë që kanë arritur, por PD nuk mund të marrë

atë që nuk i takon", -tha Rama. Apeli i kreut të qeverisë shkoi për të gjitha forcat politike në parlament, që në 21 Korrik të votojnë së bashku reformën, për tu dhënë një mesazh të gjithë qytetarëve shqiptarë se kur politika është unike, gjithçka është e arritshme. "Le të bashkojmë forcat individuale, partitë në parlament, të dyja koalicionet dhe me dy krahet lart të ngrejme shpresën e shqiptarëve që përfaqësojmë për të votuar reformën në drejtësi dhe për tu dhënë të gjithëve mesazhin se s'ka asgjë të pamundur kur të gjithë jemi bashkë", -theksoi kryeministri Rama.

Informimi

Meta bisedë telefonike me Hahn: Reforma do të miratohet

Kryetari i Kuvendit Ilir Meta zhvilloi dje në mbrëmje një bisedë telefonike me Komisionerin e BE-së për Politikën e Fqinjësisë Evropiane dhe Negociatat e Zgjerimit, Johannes Hahn me të cilin diskutuan mbi zhvillimet e fundit për miratimin e reformës në drejtësi. Meta e informoi Hahn mbi takimin mes kryetarëve të partive politike në vend dhe vuri në dukje se fryma konstruktive dhe progresi thelbësor i arritur gjatë bisedimeve në tryezën politike duhet përshëndetur pozitivisht nga të gjithë palët. Meta e siguroi Hahn se pas deklaratave të sotme dhe angazhimit të qartë të shprehur prej Ramës dhe Bashës, ekziston një predispozitë e shëndetshme për miratimin konsensual të Reformës në Drejtësi të enjten në 21 korrik 2016, paketë e cila është futur tashmë në rendin e ditës së Kuvendit. Meta ka theksuar gjatë bisedës telefonike me Komisionerin për Zgjerim Johannes Hahn se do të bëjë gjithçka për të ruajtur frymën konsensuale e konstruktive për miratimin e paketës kushtetuese të enjten në seancë plenare, në interes të ruajtjes së stabilitetit politik të vendit dhe integritetit evropian të tij, si dhe në shërbim të suksesit të fazës së ardhshme të zbatimit të kësaj reforme të rëndësishme për Shqipërinë dhe qytetarët e saj.





ESIONA KONOMI
TIRANE

Lulzim Basha ka lëshuar mbremë sinjale të qarta të një konsensusi të mundshëm mes tij dhe mazhorancës para procesit të votimit të reformës në drejtësi. Pas debateve të ashpra në mbledhjen e grupit parlamentar, kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka pranuar propozimin hibrid të SHBA dhe BE, për reformën në drejtësi. Burime brenda grupit bëjnë me dije se çështja kryesore e diskutimeve ka qenë pikërisht paketa e ndryshimeve kushtetuese, ku debati më i ashpër në mbledhje ka qenë mes kreut të demokratëve dhe deputetëve Eduard Selami e Majlinda Bregu. Burime brenda takimit, bëjnë me dije se Selami i ka thënë Bashës që e ka futur PD-në në luftë me ndërkombëtarët. Pas këtyre debateve, kreu i PD zhvilloi një bashkëbisedim të shkurtër me median, ku tha se reforma është drejt miratimit, ndërsa i bëri thirrje mazhorancës që të japë konsensusin për dy pikat e diskutueshme mes palëve. Basha u shpreh optimist për produktin e negociatave, ndërsa për herë të parë pas 1 viti diskutimesh, shqiptoi se "reforma në drejtësi do të miratohet". "Qëndrimi i grupit është unanim pro reformës dhe koheziv. Partia Demokratike është për miratimin e kësaj reforme, pro draftit mbi propozimin hibrid. Është e gatshme për zgjidhje. Priremi nga zgjidhja dhe jo bllokimi nga vota konsensuale dhe jo nga skema politike. Sot është e martë pasdite, sonte, nesër gjatë gjithë ditës qëndrojmë të hapur për negociatë. Jemi gati të ofrojmë dhe pranojmë zgjidhje të argumentuara në bazë të kësaj kornize parimesh. Nuk jam pesimist, sepse po të kishim malin e problemeve që kishim muajt më parë do thosha se kjo është një reformë drejt dështimit, por kjo është një reformë drejt miratimit. Të ulëmi të gjëmë zgjidhje për çështjen përfundimtare që e mban në mënyrë absurde peng zgjidhjen. PD dhe unë jemi këtu për të dhënë një zgjidhje konsensuale për reformën në drejtësi.

Basha jep sinjalin e konsensusit: Pranoj propozimin hibrid

"Reforma është drejt miratimit, vendim unanim në PD. Do të negociojmë dy ndasitë e vogla"



NEGOCIIMI

"Unë po mendohem të vetëpërmbahem, të zbotoj në mënyrë vullnetare moratoriumin në këtë orë të rëndësishme dhe të ftoj mazhorancën për reflektim. Qëndrimet tona janë koherente".

Jam i sigurt se me negociatë do të japim lajmin e mirë shqiptarëve", u shpreh Basha. I yetur për debatet brenda PD lidhur me qëndrimin e ambasadorit të SHBA, Basha tha është i gatshëm të diskutojë me partnerin strategjik të shqiptarëve për shqetësimet e opozitës. Sipas tij, informacionet për debate në PD vijnë të shtrembëruara. "Shqetësimi i PD-së është legjitim për shkak të keqpërdorimit të kësaj reforme. Unë po mendohem të vetëpërmbahem, të zbotoj në mënyrë vullnetare moratoriumin në këtë orë të rëndësishme dhe të ftoj mazhorancën për reflektim. Qëndrimet tona janë koherente. Ky është një debat që jam i gatshëm të

Debatet

Sherr në PD, deputetët kryqëzojnë Bashën: Të votojmë reformën

Eduard Selami: Na keni futur në kurthin e sherrit me ndërkombëtarët. Premtove se pas nenit 88 do e votoje, nuk e kuptoj pse nuk e jepni zgjidhjen?

Majlinda Bregu: Ne duhet të dalim me një zgjidhje. Duhet të votojmë reformën, ne sot jemi nevojtarë edhe për të vendosur veten në krahun e kësaj partie. Nuk mund të fshihemi pas detajeve. Nuk mund të shpallim luftë ambasadës së SHBA dhe t'i lëmë përrallat me disversantë. Ne duhet të votojmë, jo të presim votat e Metës. Ne nuk mund të presim deklaratat e Metës për të vendosur çfarë do të bëjë PD.

Astrit Patozi: Duhet të llogarisim forcat, numrat. Nuk mund të mbajmë në kurriz edhe njëllën si anti përndim dhe reforma të kalojë pa ato garantitë që thoni ju. Të shohim numrat nëse bëhemi barrikadë, bllokime një reformë të pa drejtë, përndryshe mos të marrim kosto të dyfishtë...

Igli Cara: Manovra e Ramës mos të lëshojë një element teknik është që të mos votojmë reformën. Ju keni mandatin për ta zgjidhur me Ramën. Në datë 22 në rast mos votimi shqiptarët dhe ndërkombëtarët do të vënë gishtin mbi ata që se deshin, uroj mos të jemi ne, se 99 % të punës me draftin e ka bërë PD, të mos gjeçin tek 1 %.

Lulzim Basha: Do vazhdojmë negociatat për Reformën në Drejtësi. Presim që ata të kthehen në rrugën e negociatave për reformën. Propozimi që kemi pranuar mbremë është amerikan. Unë dhe PD jemi për reformën, po punojmë për standardet.

pranoj me partnerin tonë strategjik. Por, dhe kemi pranuar propozimin e partnerit tonë strategjik dhe presim që marrëveshja të shkojë drejt miratimit,

dhe jo drejt abortimit me truke që nuk i mbështesin Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian dhe Partia Demokratike", -tha Basha.

Bregu:
"Ta miratojmë, të pastrojmë drejtësinë nga kriminelët"

Deputetja e Partisë Demokratike, Majlinda Bregu, u shpreh në një prononcim për mediat pas mbledhjes së grupit parlamentar demokrat, se PD duhet të miratojë reformën në drejtësi, për të spastruar sistemin nga kriminelët. Sipas saj, PD nuk ka rrugë tjetër veçse të votojë reformën në drejtësi të enjten e 21 Korrikut. Bregu tha se filmat me diversantë nuk i sheh që kur ishte fëmijë, duke iu përgjigjur kështu edhe etiketimit drejt deputetëve të PD që mund të votojnë reformën. "Duhet të votojmë reformën në drejtësi. Nuk shoh asnjë gjë tjetër. Filmat me diversantë dhe diversantë ajrorë nuk i shoh që kur isha fëmijë. PD duhet të vazhdojë të ketë koalicion me shqiptarët, me atë të papunin që s'ka të drejtë të marrë të drejtën e tij, me atë grupin dhe njeriun që shkon para gjykatës e nuk merr drejtësi. Gjyqtarë e prokurorë të ndershëm kanë mbi supë njëllën e korrupsionit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar", u shpreh deputetja e PD, Majlinda Bregu.

Ish-kreu i PD-së i pari që reflekton pas presionit direkt të Donald Lu

Kritika
"Lu asnjëherë nuk e ka përmendur Partinë Demokratike. Ai ka përmendur me emër kryetarin e partisë Basha. Dhe në këtë pikë unë jam plotësisht dakord me ambasadorin Lu me kritikën e drejtëpërdrejtë që i bën Bashës".

Ish-kryetari i Partisë Demokratike, aktualisht deputet, Eduard Selami ka shënuar të parin rebelim ndaj partisë së tij, duke deklaruar dje se do të votojë Reformën në Drejtësi edhe nëse Partia Demokratike do të jetë kundër saj. Selami ka theksuar se, kreu i demokratëve duhet të pranojë draftin euro-amerikan të Victoria Nuland. Ai i ka shprehur mirënjohje Shteteve të Bashkuara të Amerikës për kontributin që kanë dhënë për reformën në Drejtësi në Shqipëri, pasi pasojat nëse nuk e miraton do të bien mbi kreu e PD-së Basha dhe jo mbi PD-në. Deklarata është bërë në një intervistë për Zërin e Amerikës. "Unë shfrytëzoj rastin dhe një herë që të them se ka kohë akoma. Dëshira ime si demokrat është që zoti Basha të pranojë konsensusin, të pranojë draftin

nga zonja Nuland, të pranojë draftin euroamerikan. Përndryshe kjo do të jetë me pasojë shumë të mëdha për vetë zotin Basha. Nëse kjo nuk ndodh,

është plotësisht e mundur që kjo të kalojë në parlament. Unë jam një prej tyre. Deklaroj votën time pro Reformës, është votë për Shqipërinë europiane,

është votë kundër korrupsionit, është votë për të ardhmen e Shqipërisë. Mirënjohje Amerikës. Kanë votën time. Dhe si unë janë mjaft demokratë që deri dje mbështetën Bashën, kurse pas plotësimit të këtyre kushteve nuk ka për të patur mbështetje. Dhe ky është mendim që mbi-zotëron në anëtarësimin e Partisë demokratike. Dhe në Shqipëri, jo vetëm në bazë të anketave, por dhe në një kontakt fare të zakonshëm e shikon se shqiptarët janë të lodhur nga klasa politike. Unë kam shprehur shqetësimet e mia përpara. Ky është një moment që jepet, që edhe këta që janë faktorët kryesorë që e kanë mbajtur Shqipërinë peng deri tani të kenë një mundësi për t'u rehabilituar. Nëse nuk e kap zoti Basha, keq për të. Shqipëria do përparojë. PD do dalë më e forte", - është shprehur Eduard Selami.

Eduard Selami, rebeli i parë: Vota ime PRO edhe nëse PD është kundër

SHOQËRIA PËRMBARIMORE
"KODRA BAILIFF SERVICE" sh.p.k
NJOFITIM PËR SHITJE NË ANKAND

Më 28.07.2016, në ora 16:00 (të Enjten), zhvillohet ankandi i pare për shitjen e pasurisë se debitorit me inicialet M.SH i ddt. 10.02.1953;

Kolateralisht është:
ZK 8260, fq.16, vol.48, nr. Pasurie 3/206+1-1, apartament me sip. 130.7 m²
ZK 8260, fq.16, vol.48, nr. Pasurie 3/206+1-2, apartament me sip. 130.7 m²
ZK 8260, fq.16, vol.48, nr. Pasurie 3/206+1-3, apartament me sip. 130.7 m²
ZK 8260, fq.16, vol.48, nr. Pasurie 3/206+1-4, apartament me sip. 130.7 m²

***Cmimi me të cilin fillon ankandi i parë është 77,940 (shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzet) euro**

* Ankandi do të qëndrojë i publikuar nga data 13.07.2016 deri më datë 28.07.2016 dhe ankandi do të zhvillohet me datë 28.07.2016, në përfundim të ararit zyrtar (ora 16:00).

* Secili ofrues duhet të deponojë bashkë me kërkesën për pjesëmarrjen në ankand edhe garancinë prej 10% të cmimit fillestar në llogarinë bankare të Shoqërisë "KODRA BAILIFF SERVICE" sh.p.k pranë "BKT" sh.a me Nr. Llogarie 426725984 dhe IBAN AL8120511265725984CLPRCLALLD.

Konsensusi

Më 21 Korrik reforma miratohet me votat e jo me pak se 2/3 e Parlamentit. Konsensusi për këtë reformë për cdo ligj tjetër nuk është kërkesë e Kushtetutës dhe e ligjit por vullnet politik i partive dhe liderve të tyre

Me 21 Korrik çdo deputet i Mazhorancës dhe Opozitës dhe gjithë Parlamenti i Shqipërisë ka shansin e madh të dëshmojë me votën e vet Pro Projektin të Reformës për Drejtësinë se e do Shqipërinë, se është për pranimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, se është për forcimin e marrëdhënieve me Amerikën dhe Europën dhe jo për ta Vetëzolluar Shqipërinë dhe ndarë atë nga bota Perëndimore.

Të votosh kundër projekt-reformës për drejtësinë të hartuar nga OPDAT, EURALIUS dhe ekspertët shqiptarë dhe që mbështetet fuqimisht nga qeveria Amerikane dhe Bashkimi Europian, do të ishte veprimi më Anti-Shqiptar, më Anti-Perëndimor dhe më vrastar i idealeve për një Shqipëri Europiane.

Të nderuar deputetë,
Keni rastin të dëshmoni integritetin tuaj personal në të mirë të Shqipërisë dhe votuesve tuaj duke votuar "PO" Reformën më 21 Korrik.

Kam edhe një këshillë miqësore vecanërisht për ju deputetë të Opozitës, jo vetëm si qytetar, por edhe si ish-deputet i Partisë Demokratike i zgjedhur në Mars 1992 nga njerëzit fisnik të vendlindjes time aq të dashur-Mirditë dhe si ish-Kryetar i Komisionit të Ligjeve në Parlament. Ishin deputetët dinjitozë të Partisë Demokratike që në vitet 1992-1996, kur PD ishte në pushtet, votuan disa herë kundër urdhërave, vullnetit, dhe diktatit të Presidentit Berisha, që vepronit edhe si Kryeprokuroor, Krye-Gjykatës e Krye-Mafioz dhe që mbi Shqipërinë vendoste interesat e tij personale dhe të klanit të tij të zhytur në krim e korrupsion. Ata deputetë të nderuar përballuan kërcënimet dhe dhunën e mbipushtetit berishian ndaj kujtohen me respekt.

Sot ju deputetë të Partisë Demokratike jeni në situatë shumë më të favorshme se ata deputetë të PD të viteve 1992-1996 dhe nuk ka asnjë arsye të frikësoheni nga Salii, i cili në fakt është më i frikësuar shqiptar, me i frikësuar ish-pushtetar dhe më i frikësuar deputet, sepse ai po e ndjen peshën e rëndë të krimeve të tij. Prandaj ai po e kundërshton e saboton Reformën në Drejtësi. Frika e Berishës nuk ka pse t'ju pushtojë edhe ju e t'ju ertësojë ndërgjegjen, bindjen dhe integritetin tuaj personal.

Në fakt një gjyqësor i pavarur e me integritet që reforma synon të bëjë është edhe në të mirën e atyre që sot kanë frikë nga Reforma, pra edhe në interes të vetë Saliut dhe klanit të tij.

Unë dua të besoj se ju deputetë të partive të tjera opozitare nuk jeni pa integritet personal dhe të pranoni të komandoheni e nëpërkëmbeni nga Salii e të votoni sipas urdhërave të tij dhe jo për të mirën e votuesve tuaj dhe të Shqipërisë. Komuniteti ndërkombëtar, qytetarët e Shqipërisë përfshirë edhe veten time, besojmë dhe presim që ju të votoni "PO" Reformën më 21 Korrik.

Të nderuar deputetë, mos ia varrosni perspektivën Europiane vendit tonë të dashur. Asnjëherë deri më sot Shqipëria nuk ka qenë aq afër pragut hyrës në Bashkimin Europian dhe më një mbështetje aq të fuqishme nga miqtë dhe dashamirësit më të mëdhenj të saj-Amerika dhe Bashkimi Europian.

Por Shqipëria sot është edhe më e

NË FOTO:
Zef Brozi,
Ish-kreu i
Gjykatës së
Kasacionit



Zef Brozi: Votoni për Shqipërinë jo për Salinë

Ish-kreu i Gjykatës së Kasacionit u bën thirrje publike deputetëve të PD për të votuar Reformën në Drejtësi

rrezikuar se asnjëherë më parë që t'i mbyllin portat e familjes Europiane dhe t'i ndërpriten mbështetja jetike Amerikane e Europiane nëse ti deputet dhe Parlamentin nuk votoni «PO» Projekt-Reformën e Drejtësisë.

Studentë, nxënës, rini e fshatit dhe qytetit,

Ju rrezikoni që ëndrrat tuaja për t'u bërë qytetarë të denjë të BE-s tua shuajnë deputetët tuaj nëse votojnë kundër Reformës më 21 Korrik. Mos i lejoni ata të vrasin shpresën dhe perspektivën tuaj! Detyrojeni deputetët tuaj (pyesni kë keni nëse nuk e dini) të votojnë pro Reformën. Në Dhjetor 1990 moshatarët tuaj shembën diktaturën dhe zgjuan e bashkuan gjithë Shqipërinë me thirrjet «E duam Shqipërinë si gjithë Europa!».

Po ju ku jeni struktur?

Njerëz të mirë të Shqipërisë sonë të dashur,

Ju rrezikoni edhe që t'u hiqet e drejta për të hyrë pa viza në vendet e BE-s dhe kështu do të ndaheni nga familjet dhe të afërmit tuaj në imigracion dhe do t'ju bjerë të fikët duke pritur pa shpresë dhe me orë e ditë të tëra para dyerve të ambasadave për të marrë një vizë, sikurse vuajtët deri pak vite më parë. Mos lejoni që kjo të ndodhë! Zgjuhoni nga letargjia poshtëruese që ju ka zënë dhe detyrojeni deputetin tuaj, Parlamentin tuaj të votojë me 21 Korrik ashtu sikurse dëshëroni ju, pra Pro Reformës për Drejtësinë!

Biznesmenë e Fermerë që po jepni një kontribut të cmuar në progresin e vendit tonë të dashur,

Nëse deputeti juaj dhe Parlamenti juaj me 21 Korrik voton kundër reformës për drejtësinë, ju rrezikoni të mos merrni ndihma financiare dhe investime nga Bashkimi Europian dhe institucionet financiare Perëndimore për fermën dhe biznesin tuaj që sot keni, apo që dëshëroni të hapni; Ju

Rreziku
Por Shqipëria sot është edhe më e rrezikuar se asnjëherë më parë që t'i mbyllin portat e familjes Europiane dhe t'i ndërpriten mbështetja jetike Amerikane e Europiane nëse ti deputet dhe Parlamenti nuk votoni «PO» Projekt-Reformën e Drejtësisë

nuk do keni mundësi të shisni prodhimet e juaja në tregun e Bashkimit Europian. Mos i lejoni deputetët tuaj t'u mbyllin shanset e pasurimit dhe një jetese më të mirë për ju e familjet e juaja. Detyrojeni ata të votojnë Pro Reformës që ju e doni.

Reforma në Drejtësi duhet mbështetur edhe nga ata gjyqtarë e prokurorë të ndershëm, sepse kjo reformë synon edhe që të krijojë kushte e trajtim dinjitoz për ata e familjet e tyre dhe do të mundësojë pavarësinë reale nga partitë dhe politika.

Duke ndjekur me vëmendje edhe debatet e këtyre ditëve për reformën në Drejtësi po shpreh në mënyrë sa më të thjeshtë opinionin tim vetëm për disa çështje të debatueshme.

A është miratimi me konsensus kusht pa të cilin nuk mund të miratohen projekt-ligjet, pra edhe Projekt-Reforma në Drejtësi?

JO, projekt-reforma dhe ligjet miratohen me aq vota sa kërkon kushtetuta dhe ligji. Pra me 21 Korrik reforma miratohet me votat e jo me pak se 2/3 e Parlamentit. Konsensusi për këtë reformë për cdo ligj tjetër nuk është kërkesë e Kushtetutës dhe e ligjit por vullnet politik i partive dhe liderve të tyre. Jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet me demokraci të konsoliduar konsensusi politik shumë trallë arrihet. Që nga viti 1995 e deri më sot që unë jetoj në Amerikë, e kam të vështirë të kujtoj ndonjë rast për ndonjë ligj që Kongresi Amerikan ta ketë miratuar me konsensus. Cdo kushtëzim për reformën me konsensus është i papranueshëm në një shtet ligjor e demokratik. Mendoj se edhe institucionet ndërkombëtare kanë bërë e bëjnë gabim të madh kur instojnë për konsensus.

Për më tepër, përvoja e këtyre 25 viteve tregon se konsensusi midis partive të mëdha edhe kur është arritur, ka qenë një

paraz politik me pasojë të rënda për vendin dhe demokracinë.

A është çënim i sovranitetit pjesëmarrja dhe roli i ndërkombëtarëve në procesin e verifikimit të integritetit profesional e moral të gjyqtarëve e prokurorëve, sikurse po trumbetohet me djallëzi nga disa politikanë?

Jo, aspak. Pretendimet dhe klithmat për "cenim sovraniteti" në këtë rast janë sebepe për ta sabotuar reformën, janë ringjallje e shëmtuar e mentaliteteve të diktaturës komuniste.

A është projekt-reforma në përputhje me të ashtuquajturin Nen 88 të Komisionit të Venecias?

Edhe unë them PO, ashtu sikurse thonë ekspertët shqiptarë, BE, Sh.B.A. dhe institucione të tjera ndërkombëtare.

Por kam edhe një sugjerim për vetë Komisionin e Venecias që në të ardhmen të heqë dorë nga rekomandime politike për partitë dhe të japë vetëm opinionin profesional, sepse partitë vetë ngatërrohen e përlëshojnë për parcelizim e zabtim të gjyqësorit e prokurorisë edhe pa rekomandime joprofesionale veneciane, ndërsa sugjerimi i Venecias për zgjidhje politike që sigurojnë proporcionim të opozites dhe mazhorancës në gjyqësor e prokurori krijon sherr e keqintepretime që minojnë vetë reformën në drejtësi dhe pavarësinë e institucioneve të drejtësisë, pra i hedh benzinë zjarrit të pasuar të politikës mbrapshtake në Shqipëri.

Në mbyllje unë shpreh besimin dhe uroj që me 21 Korrik mëse 94 deputetë, mbase 139 (mbase ndodh edhe mrekullia dhe 140 deputetë) do votojnë PRO Projekt-Reformën në Drejtësi. Dhe atëherë lajme e ditë më të mira do të vijnë për qytetarët dhe Shqipërinë!

Qytetarët

Mos i lejoni deputetët tuaj t'u mbyllin shanset e pasurimit dhe një jetese më të mirë për ju e familjet e juaja. Detyrojeni ata të votojnë Pro Reformës që ju e doni

Vizat

Njerëz të mirë të Shqipërisë sonë të dashur, Ju rrezikoni edhe që t'u hiqet e drejta për të hyrë pa viza në vendet e BE-s dhe kështu do të ndaheni nga familjet dhe të afërmit tuaj në imigracion

Peza: Kush nuk e voton reformën bën vetëvrasje politike

DENIS MINGA
TIRANE

Deputeti i Partisë Socialiste, Alfred Peza, shprehet se negociatat për reformën në drejtësi vijnë edhe në nivele të larta, jashtë tryezës së negociatorëve. I ftuar në "45 minuta" nga Denis Minga, Peza tha se po negociohet etshëm për të arritur një kompromis, i cili do të bënte të mundur miratimin konsensual të reformës në 21 korrik. Ai tha se do të ishte vetëvrasje për këdo që do të votojë kundër reformës në drejtësi, ndërsa solli në vëmendje edhe mesazhet e forta të ambasadorit amerikan Donald Lu por edhe të përfaqësuesve të lartë të Brukselit. I pyetur për ecurinë e mëtejshme të mazhorancës, nëse reforma në drejtësi nuk miratohet të enjten, Peza tha se qeveria do të vijojë punën dhe kryeministri Edi Rama do të vijojë të jetë kryeministër. Sipas tij, qeveria është votuar në 23 qershor të 2013-ës, për të qeverisur vendin për katër vitet në vijim.

Z.Peza, një lajm i mirë për ju është ai i z.Selami që do të votojë reformën edhe nëse nuk e voton Basha? mund të ketë vota të tjera të PD?

Reforma në drejtësi është kryetema prej ditësh. Këdo që të pyesësh sot, kanë si kryefjalë reformën në drejtësi. Duket sikur parlamenti dhe parlamentarizmi është ndarë në dy pjesë, në neo-otomanë dhe europianistë. Të cilët e kanë vënë vendin përpara një dileme Shekspiriane, nëse Shqipëria do të rrezojë pengesën e fundit drejt integritimit, apo do të vijojë drejt një fryme neo-otomane, që do të ndërtojë një mur ndarës mes shqiptarëve dhe Brukselit nën diktaturën e një drejtësie të korruptuar. Nuk mendoj që është surprizë kjo e Selamit, po t'i referohemi qëndrimit europianist në vijimësi. Në perceptimin tim, z.Selami është një europianist.

Kjo votë a mund të kuptojë shkëputjet e tjera?

S'besoj se mund të kenë lidhje shkak pasojë. Gjykoj se PD ka ndryshuar shumë nga pozicionet e mëparshme të saj. Dhe në 24 orët e fundit ka një vullnet më të madh për të shkuar drejt arritjes së një kompromisi. Dhe mbrëmë deri në mesnatë, gati kompromisi u arrit. Presion i madh i SHBA-BE dhe koshienca e lidërsipit të PD, për këtë reformë historike, por nga ana tjetër presioni ndërkomëtar ka ardhur duke u shtuar, për t'i bërë presion të drejtpërdrejtë klasës politike shqiptare. Shqipëria është në fokusin e të gjitha kancelarëve perëndimorë tashmë. Ky moment një ligjëvëni në Shqipëri i vjen njëherë në jetë. Dhe duhet të jetë në anën e historisë.

Parlamenti më i kontestuar në këto 25 vite, mos është paksa pak

SHBA e BE

Nëse një lider politik nëse del kaq kundër në një çështje kaq të investuar nga SHBA e BE, ai nëse nuk është më partner i tyre. Një lider shqiptar s'do jetë jetëgjatë në politikë, nëse nuk ka mirëkuptimin e aleatëve

Deputeti shprehet se pavarësisht votimit më 21 korrik: "Qeveria çon deri në fund mandatin"

ironike, që ky parlament do votojë reformën më të rëndësishme në vend?

Me votimin e reformës, disa protagonistë të politikës shqiptare, do të duhet të votojnë për vete, por në fund të fundit, mund të marrësh edhe vendime që të shërbejnë pozitivisht, por mund të jetë edhe e dhimbshme për ndonjërin që do të votojë edhe kundër vetes.

Z.Rama shprehet i sigurt për 94 vota, por sa vota ka kjo reformë sot?

Si çdo gjë tjetër, politika përfundon tek matematika. Reforma në drejtësi më shumë sesa kalkulimet e vogla matematikore, është një llogari tjetër, llogari përpara historisë, përpara vetes, elektoratit dhe historisë së partive. Ky raport, ky qëndrim dhe kjo përbalje e madhe në këtë lojë të madhe pasqyrash, me një reforme që tejkalon gjithçka e bën shumë të pavëmendshme çështjen e vogël të numrave. Këtu kemi të bëjmë me qëndrime që ndajnë epokë, që ndajnë dy faza historie. S'do gjykoj mbi aritmetikën e numrave, por në qëndrimet e përgjegjshme të partive politike. Dhe do të jetë një notë e përbashkët për të gjithë klasën politike.

Ti kthehem pak negociatave për ngërçin final, dje çfarë ndodhi me

qëndrimet e tre negociatorëve?

Ka pasur një dakordësi mes negociatorëve dhe pothuajse në një masë afër 100% është rënë dakord për termat e marrëveshjes. Gjithmonë negociatat zhvillohen në prani të ekspertëve të EURALIUS e OPDAT. Ekspertët e tyre, sipas informacioneve që kam unë, kanë parë një kontradiktë që mund ta çonte zgjidhjen në Kushtetuese dhe mund ta rrezonte sepse binte ndesh me Kushtetutën. U duk sikur

u gjet zgjidhja, u pa se binte ndesh dhe është dashur një formulim për këtë pjesë.

Pse s'ka rinisur sot?

Është çështje kohe dhe mundësie e palëve. Negociatat nuk zhvillohen vetëm mes njerëzve që mblihen në një vend, por edhe në shumë rrugë të tjera. Po negociohet etshëm në çdo orë dhe në çdo minutë.

Ka një merak se mos vallë një kompromis i minutës së fundit mund ta cenojë në cilësinë e reformës...

Fakti që kemi qëndrime shumë pranë zgjidhjes, nuk ka asgjë të pakapërcyeshme. PD nuk ka hequr dorë nga pretendimet e saj, por s'po heq dorë as nga përpjekjet për të shkuar te zgjidhja.

Çfarë ka ndodhur në këto 48 orë me z.Meta?

Z.Meta është një politikan i pjekur me shumë përvojë. Është bashkëdrejtues i koalicionit qeverisës. Nga 2013-a e deri sot, në asnjë rast të vetëm, LSI nuk ka votuar asnjëherë ndryshe nga PS, çka është tregues thelbësor i mënyrës së funksionimit të koalicionit. Pra, nuk ka çëdim të boshtit të koalicionit. Pastaj, tjetra është që të gjithë aktorët kërkojnë të luajnë një rol dhe si kryetar Kuvendi ka dashur të gjejë pozicionin e tij për të ruajtur një rol më të madh për

Qeveria

Kalon apo jo reforma, qeveria do të vijojë punën deri në 2017-ën. Qytetarët e kanë votuar qeverinë Rama për të qeverisur 4 vjet. Pas votimit të reformës, në 22 Korrik ne do të flasim për atë që do të ndodhë



çështjen e reformës në drejtësi.

Po votat e LSI? Do jenë siç thotë z.Rama?

Votat e LSI s'mund të maten me çështje fraksionesh. Sa i përket elementëve të tjerë, e gjitha është pjesë e lojës politike.

A janë trembur liderët nga deklaratat e ambasadorit?

S'e di çfarë ka ndodhur, se për ta kuptuar këtë duhet të jesh më pranë tyre. SHBA kurrë një çështje nuk e ka pasur më seriozisht se reformën në drejtësi. Kur SHBA e kanë shumë seriozisht një gjë, ata e kuptojnë rëndësinë dhe delikatësinë e pozicionit të tyre në raport me atë çfarë kërkohet nga SHBA.

S'do guxojë kush të dalë kundër SHBA?

Kjo është si ajo barcaleta: "Nëse i hapim luftë Amerikës, kush rri e mban me bukë SHBA pastaj".

A do ta detyrojë SHBA politikën shqiptare që të votojë reformën në 21 korrik?

SHBA nuk e detyron, por tregon rrugën e drejtë.

A trembet z.Berisha nga pasojat e SHBA, z.Meta, z.Basha, z.Rama?

Nuk besoj se ndonjë lider politik të arrijë të mos jetë serioz në një qëndrim kaq shumë serioz, në një çështje kaq shumë serioze për ne.

Reforma votohet të enjten?

100% po, votohet. Por kurrë mos thuaj kurrë. Sirenat që i mbajnë liderët tanë të lidhur pas traut të anijes do t'i çojnë drejt Itakës, pasi ata e kuptojnë që vetëm ajo është rruga më e drejtë. Nëse dikush nuk shkon sipas interesit shqiptar, atëherë kjo do të ishte vetëvrasje politike. Nëse një lider politik nëse del kaq kundër në një çështje kaq të investuar nga SHBA e BE, ai nëse nuk është më partner i tyre. Një lider shqiptar s'do jetë jetëgjatë në politikë, nëse nuk ka mirëkuptimin e aleatëve.

Çfarë ndodh me qeverinë nëse nuk kalon reforma?

Kalon apo jo reforma, qeveria do të vijojë punën deri në 2017-ën. S'dua ta besoj që reforma s'do votohet. Qytetarët e kanë votuar qeverinë Rama për të qeverisur 4 vjet. Pas votimit të reformës, në 22 Korrik ne do të flasim për atë që do të ndodhë.

Ditën e enjte, votimi do të jetë nominal, i hapur?

Varet nga kërkesat që do të bëjnë kryetarët e grupeve parlamentare. S'është përcaktuar. Por unë do të preferoj votimin e hapura nominal.

Referendumi është mundësi?

Deri në 21 korrik nuk e shohim si mundësi. Por do të luhet e punohet me disa opsione.

Koalicioni

Nga 2013-a e deri sot, në asnjë rast të vetëm, LSI nuk ka votuar asnjëherë ndryshe nga PS, çka është tregues thelbësor i mënyrës së funksionimit të koalicionit. Pra, nuk ka çëdim të boshtit të koalicionit

Rama inaguron sallën e re operative në polici

“Policia e shtetit ecën në drejtimin e duhur. Qentë le të lehin, karvani ecën para”

Pavarësisht faktit se dita e martë ka qenë e tejmbushur me zhvillime intensive për Reformën në Drejtësi në politikën shqiptare, kryeministri Rama e ka gjetur kohën të jetë i pranishëm në inaugurimin e sallës së re operative në policinë e Tiranës. Kjo sallë e re përbëhet nga një kompleks shërbimesh të ofruara nga Policia e Shtetit ndaj qytetarëve. Kjo sallë koordinon në kohë reale shërbimet e policisë së rendit dhe policisë rrugore, në raste ngjarjesh. Po ashtu nëpërmjet sistemit GPS, sallë monitoron vendodhjen e shërbimeve të policisë rrugore me qëllim orientimin e tyre drejt zonave ku është i nevojshëm shërbimi i policisë. Po ashtu ajo monitoron në kohë reale kamerat policore të trupit, si dhe thirrjet emergjencës në Numrin Unik “112”, si dhe njoftimet në komisaratin dixhital. Aktualisht shërbimi i numrit UNIK është në funksion vetëm në tiranë ndërsa pritet të shtrihet në të gjithë vendin.

KRYEMINISTRI

Ndërkaq gjatë fjalës së tij kryeministri Rama përfitoi nga rasti për të hedhur poshtë akuzat e herë pashershme të PD-së ndaj ministrit Tahiri. Sipas Ramës, ky është një shembull që tregon se këtij ekipi i lind e drejta të thotë: Qentë le të lehin



TAHIRI

“Praktikisht, Tirana bëhet kryeqyteti i parë në Ballkan që ka një numër të integruar emergjence, pas vendeve të BE. Ne do të vazhdojmë me Durrësin, duke e shtrirë pastaj në të gjithë Shqipërinë.”

karvani shkon përpara... “Sot pashë nga afër një tjetër dëshmi të faktit se Policia e Shtetit është një nga vatrat më aktive të revolucionit tonë teknologjik dhe të transformimit të teknologjisë së re në një instrument shumë efektiv për t’ju shërbyer sa më mirë qytetarëve. Sa më

shumë Policia e Shtetit ecën në drejtimin e duhur, në drejtimin me vizion dhe me vendosmëri të Ministrit të Brendshëm aq më shumë, kësaj skuadre i lind e drejta të thotë “qentë le të lehin karvani do të ecë përpara,” tha kryeministri.

RISIA

Sistemet informatike të instaluar në Sallën e Komandimit mundësojnë që i gjithë procesi nga marrja e telefonatës deri në raportimin për ngjarjen nga patrulla të kryhet në mënyrë elektronike. Gjithashtu sallë ka mundësi të monitorojë në kohë reale vendndodhjen e patrullave nëpërmjet sistemit GPS, pjesë e kamerave të trupit. Ndërsa në raste ngjarjesh, sallë e komandimit ka mundësi të shfaqë në ekran në kohë



VIDEO / RAMA INAGURON SALLËN E RE OPERATIVE NE POLICI



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shikarokhet falas

reale, pamjet e kamerave të trupit që ndodhen në zonë ose në vendngjarje. Tirana është kryeqyteti i parë në Ballkan që implementon numrin unik 112. Në shembullin e vendeve europiane, edhe Shqipëria ka një numër të unifikuar të emergjencave “112”. Ai është një numër i përbashkët telefonik, të cilin mund ta përdorë çdo qytetar për të komunikuar me shërbimet e emergjencës si Policinë, Ambulancat, Zjarrfikësen dhe Skuadrat e Shpëtimit.

MINISTRI TAHIRI

Ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri theksoi se me risitë e fundit që Policia e Shtetit ka vënë në dispozicion për qytetarët, Tirana bëhet kryeqyteti i parë në Ballkan që ka një numër të integruar emergjence pas vendeve të BE. Ministri bëri të ditur se projekti do të vazhdojë me Durrësin, duke u shtrirë më pas në të gjithë Shqipërinë. “Kjo është sallë e operative e komandimit e Tiranës dhe numri i integruar i emergjencës. Janë operatorët e komisarateve, operatorët e qarkullimit rrugor, operatorët e Komisaritit Dixhital dhe në numri 112 qytetarët marrin dhe për Policinë e Shtetit dhe për shërbimin zjarrfikës dhe për shërbimin mjekësor dhe për çdo lloj emergjence tjetër. Praktikisht, Tirana bëhet kryeqyteti i parë në Ballkan që ka një numër të integruar emergjence, pas vendeve të BE. Ne do të vazhdojmë me Durrësin, duke e shtrirë pastaj në të gjithë Shqipërinë. Ndërkohë brenda shumë pak kohësh do të vazhdojmë edhe monitorimin e telefonatës, do të shikojmë sjelljen e operatorit dhe në çdo eventualitet më pas do ta kemi të regjistruar telefonatën e qytetarit.”

DREJTORI HODAJ

Drejtori i policisë së Tiranës Ervin Hodaj u shpreh se sallë e re erdhi si një domosdoshmëri

RAMA

“Sa më shumë Policia e Shtetit ecën në drejtimin e duhur, në drejtimin me vizion dhe me vendosmëri të Ministrit të Brendshëm aq më shumë, kësaj skuadre i lind e drejta të thotë “qentë le të lehin karvani do të ecë përpara.”

SALLA E RE

Sallë e re përbëhet nga një kompleks shërbimesh të ofruara nga Policia e Shtetit ndaj qytetarëve. Kjo sallë koordinon në kohë reale shërbimet e policisë së rendit dhe policisë rrugore, në raste ngjarjesh

e shtimit dhe zbatimit të programeve të reja në shërbim të qytetarit. Ai shpjegoi se risia e numrit të emergjencës për qytetarët është se nuk humbet asnjë telefonatë dhe se brenda një kohe të shkurtër qytetarit do t’i ofrohet shërbimi për të cilin ka nevojë. “Sallë është totalisht e rikonstruktuar. Njëkohësisht erdhi si domosdoshmëri për implementimin edhe të disa programeve të tjera. Është sistemi unik i telefonatës 112, i cili përfshin Policinë e Shtetit, urgjencën dhe zjarrfikësen. Është kryeqyteti i parë në Ballkan që implementon numrin unik, aktualisht numri 112 është implementuar në muajin qershor, në 7 qershor. Brenda muajit qershor ka rritje trefish të telefonatave në krahasim me numrat e zakonshëm që janë përdorur më parë. Risia e këtij numri është që nuk humbet asnjë telefonatë. Brenda 5 sekondave operatori përgjigjet telefonatës dhe kohëzgjatja e telefonatës është mesatarisht 38 sekonda. Pas kësaj telefonate reagojnë shërbimet. Në muajin qershor janë regjistruar 40 mijë telefonata ndërsa në muajin maj ishin regjistruar 13 mijë telefonata.”

Miratohet mes debatesh porti 5 miliardë dollarë në Kavajë

Projektligji kalon vetëm me votat e mazhorancës

Mes debatesh të shumta, është miratuar vetëm me votat e mazhorancës projektligji për ndërtimin e portit të Karpenit në Kavajë. Deputetët e djathtë akuzuan në Komisionin Parlamentar të Veprimtarive prodhuese mungesën e plotë të transparencës dhe nxitimin me të cilin u hartua dhe u kalua për miratim ligji për këtë investim me vlerë 5 miliardë dollarë. Deputeti i PD-së Helidon Bushati kërkoi më shumë detaje mbi kompanitë që qëndrojnë pas këtij

konsorciumi. Në mënyrë të veçantë për shoqërinë që ka bërë propozimin e pakërkuar për ndërtimin e Portit, kapitali i së cilës është vetëm 100 paund. “Ka një pikëpyetje të vogël që u munduam me shumë delikatesë ta anashkaloni, vetë kompania aplikuese është një kompani me një kapital prej 100 stërlinash”, u shpreh ai. Gjatë seancës dëgjimore nuk munguan as batutat. Deputeti i PS Eduard Ndocaj, tha që nëse vërtetë kompania investuese Star Bridge ka për kapital vetëm 100 paund,

MINISTRJA EKONOMI

Ministrja e Ekonomisë, Milva Ekonomi, tha se kompania që ka propozuar ndërtimin dhe shfrytëzimin e portit nuk ka kapitale pasi do të menaxhojë fondet e shoqërive që bëjnë pjesë në konsorcium

ishte i gatshëm dhe ai të bëjë bashkëinvestitor duke paguar shumën prej 100 paundësh. “Është e vërtetë që ka 100 stërlina në bankë apo u tallët si zakonisht”, tha Ndocaj. Ministrja e Ekonomisë, Milva Ekonomi, tha se

kompania që ka propozuar ndërtimin dhe shfrytëzimin e portit nuk ka kapitale pasi do të menaxhojë fondet e shoqërive që bëjnë pjesë në konsorcium. “Kompanitë kanë ardhur me përfaqësuesit e tyre disa herë, kanë regjis-



truar kompaninë në Angli dhe Uells. Është e vërtetë që kjo kompani ka një sasi parash 100 paund sepse Star Bridge është një kompani investimi dhe sipas historisë së tyre investuese portofolio mbushet dhe zbrazet në var-

ësi të projekteve”, u shpreh ajo. Votimi i projektligjit do të thotë se Qeveria do nisë pas 45 ditësh shfrytëzimin e portit të Karpenit dhe mund të miratojë brenda 2 muajsh kontratën koncesionare.

Pamjet filmike, si u grabit banka në qendër të Vlorës

Brenda 59 sekondave dy persona morën 33 mijë euro dhe 60 milion lekë

Persona të maskuar dhe të armatosur kanë hyrë në një bankë të nivelit të dytë në qytetin e Vlorës. E gjithë grabitja u 60 milion lekëve dhe 33 mijë eurove ka ndodhur brenda 59 sekondave. Televizioni "Report TV" ka siguruar pamjet filmike të grabitjes së bankës së nivelit të dytë në Vlorë, ngjarje e ndodhur me 11 korrik të këtij viti. Në këtë grabitje dy persona arritën të merrnin nga sporteli i Bankës një sasi prej 33 mijë eurosh si dhe 60 milion lekë të vjetra. Punonjësit e sigurisë nuk kanë mundur të reagojnë ndaj dy grabitësve, ndërsa ata në mënyrë kreuji të qetë kanë mundur të marrin paratë dhe të largohen. Në pamjet filmike, shihet qartë momenti i parë, kur në orën 13:56 minuta e 36 sekonda, një person i armatosur vjen nga krahu i djathtë i punonjësit të sigurisë dhe e kërcënon duke i drejtuar armën. Pas këtij veprimi punonjësi është larguar i frikësuar. Menjëherë në derën e bankës është shfaqur dhe grabitësi i dytë. Në pamjet e brendshme shihet qartë një prej punonjëseve të sigurisë ka qenë duke ndihmuar klientët i cili nuk ka reaguuar.

MOMENTI I GRABITJES

Të gjithë personat që ndodheshin brenda bankës janë shtrirë teksa kanë parë njërin prej grabitësve me armë ndër-

ASNJË I DYSHUAR

Ende nuk ka të dyshuar në lidhje me krimin ndërsa janë shoqëruar një numër i konsiderueshëm personash të cilët janë lënë të lirë nga policia.

kohë që tjetri ruante jashtë. Më pas ai i është drejtuar sportelit duke marrë dhe shumën e parave. Grabitja ka përfunduar sipas orës së kamerës së sigurisë në 13:57 minuta e 34 sekonda, pra grabitja u krye për 59 sekonda. Kjo bankë ndodhet në qendër të qytetit të Vlorës, pranë "Sheshit të Flamurit", ndërsa personat kanë ardhur nga një rrugë që kalon nga "Varrezat e Dëshmorëve" të qytetit. Ajo që shihet është se rojet e bankës janë të paarmatosur, ndërsa dyert nuk janë rrethulluese çka ndihmon grabitësit të largohen lehtësisht.

Një ditë pas grabitjes, policia gjeti një automjet "Mercedes-Benz", me ngjyrë të bardhë me targa franceze i cili ishte braktisur nga autorët, jo shumë larg Kishës Ortodokse në Vlorë. Ekspertët kanë kqyruar mjetin për të gjetur gjurmë që mund të ndihmonin policinë në zbardhjen e krimin. Ende nuk ka të dyshuar në lidhje me krimin ndërsa janë shoqëruar një numër i konsiderueshëm personash të cilët janë lënë të lirë nga policia.

HETIMET E POLICISË

Policia ka mbërritur në

vendngjarje dhe sipas hetimeve dy persona me maska dhe të armatosur me pistoletë janë futur nga dera e pasme e bankës. Grabitësit i janë drejtuar arkës dhe pasi kanë marrë shumën nga të dyja sportelet janë larguar nga vendngjarja. Sipas dëshmitë para të punonjëseve të bankës dy personat të ri në moshë e të shëndoshë ishin të maskuar e të armatosur. Ata gjithashtu raportojnë se nuk ka pasur të lënduar dhe të shtëna me armë. Njëri prej grabitësve ka vijuar aksionin brenda ambienteve të bankës dhe tjetri e ka pritur jashtë duke mbajtur nën kontroll rojen e sigurisë, më pas të dy pasi kanë larguar me një automjet. Policia e Vlorës ka ngritur disa pika kontrolli në akset kryesore hyrëse dhe dalje të qytetit, por kjo nuk ka dhënë asnjë rezultat për kapjen e autorëve.



Momenti kur hyn grabitësi në bank

Largimi

Njëri prej grabitësve ka vijuar aksionin brenda ambienteve të bankës dhe tjetri e ka pritur jashtë duke mbajtur nën kontroll rojen e sigurisë, më pas të dy pasi kanë ecur disa metra në këmbë janë larguar me një automjet.

VIDEO/ MOMENTI I GRABITJES SE BANKES NE VLORE NGA GRABITESIT



Për të parë videon në smartphon tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

LAJME SHKURT

Mat, gruaja braktis foshnjën dy muajsh në fagonin e linjës

Një grua ka braktisur foshnjën e saj dy-muajshe teksa ka qenë duke udhëtuar drejt qytetit të Matit. Të dhënat e para bëjnë të ditur se, gruaja e moshës rreth 22-vjeçare ia ka lënë në fagon foshnjën, të seksit maskull, një gruaje që ka qenë aty, me pretekstin se do të kthehej më vonë. Por ajo nuk është kthyer dhe ajo ka njoftuar policinë. Sipas dëshmitë së gruas që ka mbajtur fëmijën, gruaja ka qenë e panjohur prej saj dhe dyshon se është nga Saranda. Menjëherë policia ka nisur kërkimet për nënën e foshnjës, ndërkohë që po merr në pyetje edhe shoferin e fagonit të linjës Burrel-Klos në të cilin u braktis dhe foshnja.

Asgjësohen mbi 7 bimë hashashi në Gjirokastrë dhe Përmet

Nga kontrolli i ushtruar në Gjirokastrë dhe Përmet policia ka asgjësuar 7467 bimë kanabis sativa. 1340 rrënjë janë asgjësuar në Malin e Gjerë pranë vendit të quajtur "Gropat e Fërthit" në Gjirokastrë. Në kuadër të këtij operacioni është arrestuar Laze Beqiraj, 49-vjeç dhe është shpallur në kërkim një shtetas tjetër. Në Përmet policia ka asgjësuar 6127 bimë kanabis të cilat janë lokalizuar e Bënjë. Policia ka shpallur në kërkim autorin A.Xh, ndërkohë që po vijon puna për kapjen e tij.

Aksident në aksin rrugor Shkodër-Muriqan, humb jetën një person

Tre persona udhëtonin një motorçikletë tip "Lifan"

Një i vdekur dhe 2 të plagosur është bilanci i aksidentit të rëndë të ndodhur në aksin Shkodër- Muriqan, ku motorçikleta është përplasur me një automjet. Motorçikleta tip "Lifan" që drejtohej nga 35-vjeçari Agron Shtogu në të cilin udhëtonin 3 pjestarët e familjes Shtogu është përplasur me automjetin tip "Golf" me targa AA 518 AL, i drejtuar nga Emirjan Qehaja, 27-vjeç. Përplasja ka rezultuar fatale për 35-vjeçarin Agron Shtogu, i cili ka humbur jetën menjëherë, ndërsa në gjendje kritike

për jetën është edhe i mituri 3-vjeç S. SH ndërsa plagë ka marrë edhe bashkëshortja e viktimit B.SH 37-vjeçe. Të plagosurit janë dërguar menjëherë në spitalin e Shkodrës ku edhe kanë marrë ndihmën e parë ndërsa i mituri ndodhet në reanimacion e ëma është jashtë rrethit për jetën. Në vendngjarje kanë mbërritur dhe efektivet e policisë rrugore të cilët kanë nisur punën për zbardhjen e shkaqeve të aksidentit. Dyshohet se motorçikleta i ka prerë rrugën automjetit dhe më pas është përplasur me të. Pavarësisht se automjeti është ndaluar menjëherë, 35-vjeçari ka ndërruar jetë pasi ka marrë plagë të rënda në kokë pasi ka qenë pa skafandë mbrojtëse. Policia ka shoqëruar në komisariat 27-vjeçarin Emirjan Qehaja deri në sqarimin e plotë të rrethanave të aksidentit të rëndë ku humbi jetën i person ndërsa mbeten të plagosur 2 të tjerë mes tyre edhe një fëmijë i mitur.



200 MIJË LEKË TË REJA

Grabitet me pistoletë lodër xhiroja e kazinosë tek "21 dhjetori"

Një sallë e lojrave të fatit pranë kryqëzimit të 21 dhjetorit është sulmuar nga një person i armatosur mesditën e kësaj të marte në kryeqytet. Ngjarja ndodhi rreth orës 13:30, kur një person që mbante një pistoletë lodër në dorë hyri në ambientet e kazinosë, duke marrë që aty xhiron ditore. Sipas burimeve të policisë personi ka përdorur pistoletën lodër prej kauçuku për të kërcënuar punonjësit e kazinosë të cilët i kanë dorëzuar paratë grabitësit. Ende nuk ka një konfirmim zyrtar në lidhje me shumën e grabitur, por burimet e policisë thonë se ajo mendohet se arrin në rreth 200 mijë lekë të reja. Në largim e sipër sipas policisë, personit i është përplasur dora në derën e jashtme të kazinosë, çka ka bërë që arma lodër të thyhet. Policia ka nisur hetimet për krimin, ndërsa arma lodër është sekuestruar në cilësinë e provës materiale nga hetuesit.

OFERTË PUNËSIMI

Kompania mediatike Shqiptarja.com kërkon të punësojë menaxher marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

- Të ketë arsim të lartë
- Të ketë përvojë pune
- Të jetë i gatshëm për të punuar në terren

Personat e interesuar të dërgojnë CV e tyre në adresën: marketing@shqiptarja.com

Neutralizimi

Personi, i identifikuar si Kristi Zekolli, u neutralizua nga policia ndërsa nga përplasja me policinë ai mbeti i plagosur lehtë, ndërsa iu bllokua edhe një armë zjarri pistoletë

Tentoi t'i largohet postbllokut kapet me armë në dorë

Policia qëlloi me armë ndaj Kristi Zekollit për ta ndaluar. I riu u plagos lehtë



Një person i dyshuar për trafik droge dhe i dënua për armëmbajtje pa leje e kanosje të punonjësve të policisë, theu këtë paradite një postbllok të njësisë operacionale në qytetin e Korçës duke rrezikuar jetën e duke plagosur tre prej efektivëve të policisë. Personi, i identifikuar si Kristi Zekolli, u neutralizua nga policia ndërsa nga përplasja me policinë ai mbeti i plagosur lehtë, ndërsa iu bllokua edhe një armë zjarri pistoletë. Ngjarja ndodhi në hyrje të qytetit të Korçës, ku efektivët e njësisë operacionale kishin ngritur një postbllok për të ndaluar një grup personash të dyshuar si pjesëtarë të

PISTOLETA

Efektivët sekuestruan në vendin e ngjarjes armën që posedohej nga Zekolli, një pistoletë "TT" dhe një krehër me fishekë. Sipas policisë këtë armë Zekolli e mbante në dorë në momentin e kalimit të postbllokut.

një grupi të trafikut të drogës nga Shqipëria.

U PLAGOS LEHTË

Sipas njoftimit zyrtar të policisë, Zekolli, nuk iu përgjigj thirrjes së postbllokut të dyshuar në hyrje të Korçës. Ai kaloi me mjetin e tij përmes postbllokut, duke rrezikuar jetën e efektivëve që ndodheshin aty. Por pas këtij veprimi, efektivët e njësisë operacionale ndërhyrën duke hapur zjarr në ajër dhe më pas në drejtim të gomave të automjetit të tij tip "Mercedes-Benz" me targë AA 547 HV. Mjeti i Zekollit, u përplasur dhe ky i fundit ka mbetur i plagosur lehtë. Menjëherë ai u prangos nga blutë dhe u dërgua në ambientet e policisë së Korçës. Efektivët sekuestruan në vendin e ngjarjes armën që posedohej nga Zekolli, një pistoletë "TT" dhe një krehër me fishekë. Sipas policisë këtë armë Zekolli e mbante në dorë në momentin e ka-

limit të postbllokut.

DYSHIMET PËR TË ARRESTUARIN

Zekolli, dyshohet se është pjesë e një grupi të trafikut të drogës nga Shqipëria drejt vendeve fqinje. Veç precedentëve penalë në Shqipëri, ai është i dënua edhe në Itali për trafik droge dhe dyshohet se ishte një prej pilotëve që kryente transportimin e lëndës narkotike


limit të postbllokut.

I DËNUAR NË ITALI

I arrestuari dyshohet ishte subjekt i një hetimi, detajet e të cilit nuk jepen ende për shkak të sekretit që përmban çështje. Zekolli, dyshohet se është pjesë e një grupi të trafikut të drogës nga Shqipëria drejt vendeve fqinje. Veç precedentëve penalë në

AKSIONI

Sekuestrohen armë e drogë në Vlorë, 8 persona në pranga



Tetë persona kanë përfunduar në pranga gjatë një operacioni në Vlorë. Sipas njoftimit zyrtar arrestimi i tyre u bë pasi janë kapur në flagrancë në fshatin Tragjas i Vjetër, pranë vendit të quajtur "Përroi i vilave", në një parcelë të hapur posaçërisht për kultivimin e bimëve narkotike, në të cilën u gjetën të mbjella rreth 1000 rrënjë bimë të llojit Cannabis Sativa. Policia bëri asgjësimin e tyre me copëtim dhe djegie me zjarr. Në të njëjtën kohë gjatë aktonit u gjetën edhe katër armë zjarri.

KAPSHTICE/ "SISMEK KULAKOGLU NË ROLIN KORRIERIT" Turku trafik droge me trailer kapet në Kapshticë me 260 kg hashash



DROGA

Lënda narkotike sipas policisë, ishte ambalazhuar me pako prej më tepër se 1 kilogramë secila. Lënda narkotike u kap gjatë kontrollit në skaner nga dogana në vijën e dytë të kufirit

Policia kufitare në Kapshticë goditi këtë të martë një rast të trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike që niste nga Shqipëria me destinacion Turqinë. 253 pako me lëndë narkotike me një peshë prej 260 kg kanabis sativa u sekuestruan nga policia ndërsa shoferi turk i kamionit trajler u arrestua në flagrancë. Lënda narkotike sipas policisë, ishte ambalazhuar me pako prej më tepër se 1 kilogramë secila. Lënda narkotike u kap gjatë kontrollit në skaner nga dogana në vijën e dytë të kufirit. Sipas njoftimit zyrtar të policisë, gjatë kontrollit të mjetit kamion të markës "Renault" me ngjyrë të kuqe, me targa turke 34 BZ 5293, e drejtuar nga turku Sismek Kulakoglu, është krijuar dyshimi për trafik të lëndëve narkotike. Menjëherë pas kontrollit me skaner është zbuluar edhe sasia e drogës. Lënda narkotike ishte fshehur në dyshemenë e kamionit në një shtresë të posaçme të dyfishtë të krijuar për të. Policia ka

shpërndarë pamjet që i përkasin pikërisht momentit kur efektivët e policisë prangosin shoferin turk të kamionit, Sismek Kulakoglu, ku tregohet edhe shtresa dyfishe e krijuar në dyshemenë e kamionit. Ndërkohë Report Tv disponon foton e urdhrit të doganës për kryerjen e skanimit të këtij

kamioni, pas ngritjes së dyshimeve se mjeti mund të ishte përfshirë në një situatë trafiku. Pas ndalimit të shoferit turk, policia dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda kanë nisur hetimet për të identifikuar edhe persona të tjerë të mundshëm të përfshirë këtë linjë të trafikut të drogës.



Kamioni ku u gjend droga

SHKODER/ DUSHAJ KERKOI MESHIRE PARA GJYKATES

Vrau dy vllazër, 35 vjet burg Aleksandër Dushaj



Aleksandër Dushaj

Me 35 vjet burg gjykata e Shkodrës dënoi 31 vjeçarin Aleksandër Dushajn, autorin e vrasjes së dy vëllezërve Shkami në Postribë të Malësisë së Madhe. Prokurori Simon Pashuku i cili në sëancën e vendimit pas transferimit në Lezhë u zëvendësua nga Xhevahir Lika, kishte kërkuar më herët dënimin ekstrem atë të burgimit përjetë, por që nuk u pranua nga trupa gjyquese. Por avokati Albert Keraj rënditi edhe rrethanat cilësuese ndaj klientit

të tij, si vetëdorëzimin, bashkëpunimin me drejtësinë dhe pendesën e shfaqur për krimin e kryer, gjë që sipas tij e bëjnë legjitime kërkesën për aplikim të dënitimit minimal. Vetë Dushaj shprehu keqardhjen për atë që ka ndodhur, duke thënë se nuk e kishte kryer qëllimisht krimin, por në situatë të rënduar psikologjike pas sharjeve e fyerjeve që i kishin bërë dy vëllezërit Shkami që nuk pranonin krushqinë. Ai kërkoi mëshirë përpara gjykatës.

Takimet

Tre përfituesit e tokës më pas kanë vazhduar takimet mes tyre për të siguruar shumën e parave dhe për të pritur momentin e dhënies së parave pak përpara se të jepej vendimi në Gjykatën e Lartë.



Toka

Për këtë çështje është ofruar edhe tokë, ku çifti Andrea do ishin pronarë në këmbim të vendimit gjyqësor në këmbim të vendimit, por ky propozim është refuzuar nga bashkëshorti i gjyqtarës dhe vetë gjyqtarja Andrea.

NË FOTO: Gjyqtarja e Gjykatës së Lartë, ajllinda Andrea

Prokuroria e Përgjithshëm nis hetimin pasuror ndaj gjyqtarës së Gjykatës së Lartë tashmë të pezulluar nga detyra Majlinda Andrea. Mësohet se prokurori Arben Kraja, ka urdhëruar verifikimin e pasurisë së gjyqtarës Andrea dhe familjarëve të saj. Mësohet se prokurori, ka kërkuar nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit e Kontrollit të Pasurisë t'i vërë në dispozicion deklaratat e pasurisë së gjyqtarës Andrea ndër vite dhe bashkëshortit të saj, Odhise Andrea që mbante detyrën e Këshilltari në Komisionin e Sigurisë Kombëtare në Kuvend. Veç ILDKP-së, mësohet se prokuroria i ka nisur shkresë zyrtare edhe Hipotekës ku i kërkohet të evidentohen të gjithë pronat e patundshme që figurojnë në emër të gjyqtarës, bashkëshortit dhe tringut të afërm familjar. Sipas akuzës, edhe bankave të nivelit të dytë i është kërkuar identifikimi i logarive bankare dhe evidentimi i shumave që disponojnë. Me administrimin e këtyre shkresave dhe evidentimin e pasurisë, prokurorët thonë se do të vendoset sekustrimi i tyre deri në një vendim tjetër. Kjo për shkak se jnanë krijuar dyhime të arsyeshme se gjyqtarja Majlinda Andrea në bashkëpunim me bashkshortin e saj ka konsumuar veprën penale të "korrupsionit pasiv të gjyqtarëve".

Prokuroria hetim pasurie gjyqtarës Andrea

Adriatik Llalla kërkon deklaratat e pasurisë dhe kërkohet informacion shtesë nga hipoteka

prokurorit Llalla. Ka qënë një strukturë e grupit të vëzhgimit pranë policisë së Shtetit ajo që ka fotografimin dhe filmimin e personave që kanë kryer dhënien e parave. Për të zgjidhur çështjen, ndërmjetësi ka ofruar t'i japë ai paratë për llogari të Ilija Çabirit dhe Eleni Litos, të cilët janë pala përfituese në proces gjyqësor. Për këtë çështje është ofruar edhe tokë, ku çifti Andrea do ishin pronarë në këmbim të vendimit gjyqësor në këmbim të vendimit, por ky propozim është refuzuar nga bashkëshorti i gjyqtarës dhe vetë gjyqtarja Andrea.



Bashkëshorti i Majlindës, Odhise Andrea

DASHI PAGOI EUROT DO BËHEJ PRONAR

Dashi ka ofruar paratë e tij dhe ka nënshkruar një kontratë noteriale me përfituesit e pronës, të cilët ishin në pritje të njohjes së pronësisë për 40 hektarë tokë në Sarandë. Sipas prokurorisë, provohet se tre shtetasit Ilija Çabiri, Eleni Lino dhe Petraq Dashi do të jenë përfitues të sipërfaqes së tokës që kërkohet të kthehet në favor të trashëgimtarëve të ish-pronarit të pretenduar dhe se këta persona janë interesuar drejtpërdrejt në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor

në Gjykatën e Lartë. Nga hetimi provohet se këta persona bisedojnë në mënyrë të qartë në lidhje me shumën që duhet të paguhet për efekt të procesit gjyqësor, për shumën që duhet të kontribuojnë edhe personat e tjerë trashëgimtarë të ish-pronarit.

ULJA ME 10 MJË EURO E ÇMIMIT TË VENDIMIT

Në datën 10 korrik 2016 ata janë njoftuar nga shtetasi Petraq Dashi se duhet që të tyre pagujnë shumën 50, shumë e cila nga kronologjia dhe konteksti i bisedave të tyre është shuma prej 50.000 euro. Dyshohet se shuma e mësipërme është siguruar nga shtetasi Petraq Dashi dhe se dy personat e tjerë kanë nënshkruar deklaratat noteriale, sipas të cilave ata ia njohin pjesën e detyrimit të tyre si borxh shtetasit Petraq Dashi. Shtetasi Petraq Dashi gjatë kësaj kohe ka qënë në pritje të përgjigjes së mikut të tij që nga kronologjia e veprimeve është shtetasi Odhise Andrea. Ai ka folur për kostot e procesit me shtetasin Ilija Çabiri menjëherë pasi ka takuar shtetasin Odhise Andrea në datën 7 korrik 2016. Ka konfirmuar faktin se personi i mësipërm nuk dëshironte tokë por vlerë monetare. Dashi tha se iu ka ulur nga 60 në 50 shumën e kërkuar që është sipas tij dëqka e madhe - thuhet në dosjen e prokurorisë. Tre përfituesit e tokës më pas kanë vazhduar takimet mes tyre për të siguruar shumën e parave dhe për të pritur momentin e dhënies së parave pak përpara se të jepej vendimi në Gjykatën e Lartë.

VENDIMI/ SHKARKIMI I KRYEBASHKIAKUT TË DIBRËS Videoskandali i Shukri Xhelilit gjykata tërhiqet për vendimin

Gjykata Kushtetuese i jep fund gjykimit të video skandalit seksual ku u përfshi ish-kryebashkiaku i Dibrës Shukri Xhelili dhe njofton se vendimi për këtë rast do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të kësaj gjykate brënda muajit korrik. Koha në të cilën u xhirua vidoskandali seksual i ish kryebashkiakut Shukri Xhelilit nuk është saktësuar dhe pse tashmë prokuroria ka kryer hetimet. Ky fakt u bë publik nga palët në procesin gjyqësor në Kushtetuese



GJYQI

Në përfundim të këtij procesi palët nuk ndryshuan qëndrimet e tyre ku avokati i Xhelilit kërkoi shfuqizimin e vendimit të qeverisë që e ka shkarkuar kryebashkiakun nga detyra pasi sipas tij video është e manipuluar.

aty ku këtë të hënë u administruan si prova pamjet filmike, deklaratimet e vajzës me iniciale A.A që kallëzoi në polici Xhelilin. Në përfundim të këtij procesi palët nuk ndryshuan qëndrimet e tyre ku avokati i Xhelilit kërkoi

shfuqizimin e vendimit të qeverisë që e ka shkarkuar kryebashkiakun nga detyra pasi sipas tij video është e manipuluar. Për Artur Metanin, juristin e këshillit të ministrave vendimi është i drejtë dhe



Shukri Xhelili

duhet të mbetet në fuqi. Pas dy seancave publike gjykata kushtetuese u tërhoq për vendim dhe pritet që brënda muajit korrik ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të internetit të kushtetueses. Xhelili. qëndron me masë

sigurie arrest me burg dhënë nga krimet e rënda aty ku po hetohet për veprën penale të korrupsionit të zyrtarëve të lartë dhe kërkimi të favoreve seksuale kundrejt punësitit si magaziniere të shtetas A.A.

KËSTI 6

Duke filluar nga java e ardhshme ish të përndjekurit politik që janë gjallë dhe që futen te kategoritë parësore do të fillojnë të marrin këstin e gjashtë

DRICIM ÇAKA
TIRANË

Duke filluar nga java e ardhshme ish të përndjekurit politik që janë gjallë dhe që futen te kategoritë parësore do të fillojnë të marrin këstin e gjashtë. Burime nga nga Ministria e Financave bëjnë me dije se janë gati pagesat për një grup ish të dënuarish politik, të cilët do të marrin këstin e gjashtë. Në total janë 2400 ish të përndjekur politik që përfshihen te kategoritë parësore dhe që do të marrin këstin e 6-të të dëmshpërblimit. Deri tani financat nuk kanë bërë pagesën e kështit të gjashtë për asnjë ish të përndjekur. Ende nuk dihet pse është vonuar pagesa e këtij kësti. Gjatë 2015 dhe muajt e parë të 2016-s, Ministria e Financave ka paguar këstin e pestë për ata ish të dënuar që nuk e kishin përfituar. Ndërkohë që fondet për kategorinë parësore janë shumë të mëdha, pagesa e kështit të gjashtë nuk po bëhet në kohë. Më herë drejtori i Institutit të ish të Përndjekurve Politik Bilal Kola tha për gazetën se ka vonesa për këstin e gjashtë nga ana e ministrisë, por ky këst do jepet brenda vitit 2016.

PAGESAT
Pagesat e para do bëhen brenda këtij muaji, ndërkohë që procesi pritet të mbyllet deri në dhjetor të 2016-s. Të kontaktuar nga gazeta, Ministria e Financave tha se vonesa e pagesës ka ndodhur për shkak se ish të përndjekurit politik nuk kanë dorëzuar në kohë dy dokumentat që parashikohin ligji: Certifikatën personale që vërteton se janë gjallë dhe numërin e llogarisë bankare.

TRASHEGIMTARËT
Por ndërkohë që 70% e

VONESA
Të kontaktuar nga gazeta, Ministria e Financave tha se vonesa e pagesës ka ndodhur për shkak se ish të përndjekurit politik nuk kanë dorëzuar në kohë dy dokumentat që parashikohin ligji



KUVENDI

Arben Malaj anëtar i ri i Këshillit Mbikëqyrës të BSH



Arben Malaj, ish-deputeti socialist i Vlorës, pritet të jetë anëtar i ri i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Malaj do të zëvendësojë Ermelidna Maksin, ndërkohë që sot në Komisionin e Ekonomisë ka mundur që të marrë votat e mazhorancës, pas nominimit të tij, ku kundërshti nuk kanë pasur as deputetët e opozitës, ndonëse ish-ministri i Financave, Ritvan Bode i ka kërkuar që ai të shikojë me prioritet shqetësimet lidhur me politikën monetare. Duke iu përgjigjur Bodes, Malaj ka thënë se rritja e konsumit mund të vijë nga rritja e të ardhurave dhe kreditimi. Malaj, ka mbajtur edhe postin e Ministrit të Financave në qeverinë Nano.

Nis pagesa për ata që janë gjallë dhe trashgimtarët

Dëmshpërblimi i ish të përndjekurve politik deri tani ka ngecur. Financat: Shkak vonesa e dokumentave

TRASHEGIMTARËT

Procesi i dëmshpërblimit të trashgimtarëve ka ngecur në vend, kjo edhe për faktin e fondeve të ulta. Ministria e Financave pritet të bëjë edhe pagesa për këstin e parë dhe të dytë brenda muajve korrik-gusht

PERJASHTIMI

Ata trashgimtarë që kanë marrë këstin e dytë, nuk do të jenë pjesë e procesit të dëmshpërblimit. Brenda këtij viti pritet të mbyllet dhënia e kështit të parë dhe më pas do vijohet me këstin e dytë



me dhënien e kështit të tretë. Pra ata trashgimtarë që kanë marrë këstin e dytë, nuk do të jenë pjesë e procesit të dëmshpërblimit. Brenda këtij viti pritet të mbyllet dhënia e kështit të parë dhe më pas do vijohet me këstin e dytë.

fondit të qeverisë jepet për ish të përndjekurit politik që janë gjallë, pjesa tjetër i shpërndahet trashgimtarëve. Procesi i dëmshpërblimit të trashgimtarëve ka ngecur në vend, kjo edhe për faktin e fondeve të ulta. Ministria e Financave pritet të bëjë edhe pagesa për këstin e parë dhe

të dytë brenda muajve korrik-gusht. Por këto pagesa do të bëhen vetëm për ata që nuk kanë marrë këstin e parë dhe këstin e dytë. Me ndryshimin në ligjin e ish të përndjekurve politik është vendosur që, për trashgimtarët do të jepet njëherë kësti i parë dhe kësti i dytë dhe më pas do vijohet

PROJEKTLIGJI RI/ KUNDERSHTOJNE SHOQATAT

“Fëmijëve me aftësi të kufizuar do u hiqet pagesa prej 9700 lekë”

Një projektligji i ri i Ministrisë së Mirëqenies Sociale parashikon që fëmijëve me aftësi të kufizuar t’u hiqet pagesa prej 9700 lekësh që marrin në muaj. Sipas projektligjit kjo pagesë do konvertohet në shërbime. Por sipas Shoqatës “Down Sindrom” heqja e pagesës është një problem i madh për prindërit. Mirela Juka koordi-

natore e kësaj shoqate thotë se nuk ka ambiente që fëmijët me aftësi të kufizuar të marrin shërbime. “Në një nga këto diskutime është përmendur që fëmijët me aftësi të kufizuar nga ora deri në 2 vjeç do i hiqet pagesa e aftësisë së kufizuar sepse do i konvertohet në shërbime. Në qoftë se ti i heq pagesën ne e dimë që s’ka shërbime sidomos në rreth-

në Shqipëri atëherë këtu kemi një ngërç dhe një problem shumë të madh. Ne nuk po zgjidhim gjë për këtë plan po vetëm po hapim probleme. Pagesa ne cash është 9700 lek. Prindërit duhet të heqin dorë nga puna për tu marrë me fëmijën dhe nuk e marrin pagesën”, shprehet Juka. Juka shprehet se prindërit tashmë duhet të lënë punën

për t’u kujdesur për fëmijën e tyre deri në moshën 2 vjeç dhe në këtë rast nuk do marrin as pagesën. Gjithashtu ky projektligji është kundërshtuar edhe nga shoqatat e tjera të aftësisë së kufizuar. Kjo për shkak se ul pagesën për disa kategori, aq sa është pensioni social, pra 6750 lekë, ndërkohë që tani masa e pagesës është më e lartë.

VLORË

Vatër zjarri në Pishporo digjen dhjetra hektarë me pyje



Vatra e zjarrit që është shfaqur prej dy ditësh në zonën e Pishporos në Vlorë është riaktivizuar fuqishëm pasditen e kësaj të marte, ku shërbimi zjarrfikës ka ndërhyrë për neutralizimin e zjarrit, por dëmet kanë qenë të mëdha. Sipas ekspertëve deri tani janë djegur dhjetra hektarë me pyje, ku për shuarjen e tij janë angazhuar 3 makina zjarrfikëse dhe 30 zjarrfikës. Gjatë ditës së djeshme u dogjën rreth 300 ha pyje në zonën e Pishporos dhe Hidrovot.





GJOBAT

Personave, që kërkojnë t'i përdorin sërish makinat, u falen detyrimet tatimore përpara muajit dhjetor të vitit 2011. Por duhet të paguajnë detyrimet pas muajit janarit të vitit 2012. Ndërkohë, do t'u falen gjithë gjrobat për këtë periudhë

Amnistia, ja kujt i "fshihen" detyrimet dhe gjrobat e makinave

Gjobat, taksat, qeveria sot merr në analizë projektligjin e përgatitur nga Financat

Kush ka gjoba dhe taksat të papaguara për makinën që nuk e përdor, ka shansin që këto t'i fshihen. Kjo masë, si dhe të tjera që lidhen me fshirjen e detyrimeve të biznesit ndaj shtetit, përfshihen në një projektligj për "Faljen e pjeshme të detyrimeve tatimore dhe doganore,

dënimet për kontributet e sigurimeve si dhe çregjistrimin e mjeteve të transportit dhe shuarjen e detyrimeve të tyre", që pritet të shkojë sot për miratim në mbledhjen e qeverisë.

MAKINAT

Drafti parashikon çregjistrimin e të gjitha mjeteve e regjistruara në

Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, të cilat nuk kanë kryer asnjë veprim me këto mjete që nga 31 dhjetori 2011 e këtej. Çregjistrimi i mjeteve parashikohet nga drafti i ministrit së Financave që të bëhet pa paguar detyrimet e prapambetura, si: taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve dhe taksën vjetore të qarkullimit rrugor, taksën vjetore të mjeteve të përdorura, taksën e mjeteve luksoze, si dhe gjrobat e llogaritura për efekt të mospagimit të taksave e tarifave.

AFATI

Tatimpaguesit/personat përgjegjës kanë të drejtë që brenda datës 31.03.2017 të paraqiten pranë DPSH-TRR për të kryer, pa pagesë, veprimet e çregjistrimit apo për të kërkuar moskryerjen e procedurës së çregjistrimit të mjetit dhe mbajtjen aktiv të tij.

PËRDORIMI

Por, drafti nuk përfshin vetëm makinat që nuk do të përdoren më. Ajo hap një mundësi të kufizuar edhe për lehtësimin e detyrimit për ato makina, që kanë gjoba e detyrime, por pronarët e tyre dëshirojnë sërish t'i përdorin. Kështu, parashikohet që personave, të cilët paraqiten dhe kërkojnë moskryerjen e procedurës së çregjistrimit të mjetit dhe mbajtjen aktiv të tij, u falen detyrimet tatimore të makinës për periudhat përpara dhjetorit 2011 dhe duhet të kryejnë pagesat e të gjitha detyrimeve që i përkasin periudhave pas janarit 2012. Por sërish përfshihen nga fakti që u falen gjrobat për këtë periudhë.

DOGANA

Drafti parashikon edhe faljen e dënimeve/gjobave që janë pjesë e detyrimeve të pagueshme në doganë për mjetet, të cilat kanë hyrë në territorin doganor shqiptar në mënyrë të parregullt nën regjimin e lejimit të përkohshëm, me kusht që detyrimet që paguhën në import, interesat e lidhura me to të paguhën brenda datës 31 mars 2017.

NXJERRJA JASHTË QARKULLIMIT

Nëse brenda datës 31.03.2017 personat e interesuar nuk paraqiten për të kërkuar mbajtjen aktiv të mjetit, DPSHTRR-ja do të kryejë pa pagesë, çregjistrimin e mjeteve dhe shuan detyrimet tatimore për këto mjete. Lista e mjeteve me targa të përkatëse të çregjistruara sipas këtij ligji i dërgohet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit për bllokimin dhe sekuestrimin e tyre.

Biznesi, falen apo reduktohen taksat e papaguara që nga 2011

Zerohen detyrimet para 2011, më pas ulet 30% e anulohen gjrobat

Në projektligjin që po paraqitet në qeveri, në ndryshim nga drafti paraprak, parashikohet që të falen të gjithë detyrimet e gjobat e para vitit 2011, ndërsa pas këtij viti falen gjobat dhe 30% e detyrimit, me kusht që të paguhet 70% e detyrimit deri në mars 2017. Fjala është për detyrimet fiskale të prapambetura të bizneseve. Për kontributet e sigurimeve shëndetësore e shoqërore falen vetëm gjobat, pa kusht për periudhën e para 2011-ës, ndërsa për periudhën pas 2011 falen gjobat, por me kusht që të paguhet kontributet dhe kamatvonesat.

KUSH PËRFITON NGA BIZNESI

Nga kjo amnisti përfitojnë tatimpaguesit e regjistruar në regjistrin aktiv, pasiv ose tatimpaguesit të çregjistruar, për detyrime tatimore ndaj administratës tatimore qendrore dhe vendore; tatimpaguesit debitorë ndaj administratës doganore dhe pronarët e mjeteve të transportit. Ndërsa nuk përfitojnë tatimpaguesit që kanë detyrime tatimore/doganore, të cilët janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për fshehje të ardhurash dhe evazion tatimor dhe doganor, ose kontrabandë.

DERI NË DHJETOR 2011

Sipas draftit falen pa kusht detyrimet tatimore (tatimin/kontributin/taksën, kamatvonesën dhe çdo dënim administrativ të lidhur me një lloj tatimi/takse/ kontributi ose jo), që rezultojnë të papaguara dhe që u përkasin periudhave tatimore Dhjetor 2011 e më parë, pavarësisht datës së konstatimit apo evidentimit të tyre, por që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e tatimpaguesve në datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, përveç kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Falen pa kusht dënimet administrative (gjobat) për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, që u përkasin periudhave tatimore dhjetor 2011 e më parë.

Janë gjithashtu objekt i faljes sipas këtij neni, detyrimet tatimore të mëposhtme që janë të regjistruara në llogarinë e tatimpaguesit në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pavarësisht periudhës që i përkasin:

a) detyrimet tatimore përfshirë tatimin/kontributin/taksën, kamatvonesën dhe dënimet administrative për tatimpaguesit persona fizikë ose juridike, të cilët rezultojnë të çregjistruar nga QKR/ QKB, me vendim gjykatë, ose që janë të çregjistruar në administratën tatimore.


b) Dënimet administrative (gjobat) tatimore përfshirë edhe dënimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të llogaritura automatikisht nga sistemi për deklarim të vonuar

c) Janë objekt i kësaj pike edhe dënimet administrative për deklarata të padorëzuara me kusht që çdo deklarata e padorëzuar të dorëzohet deri në datën 31.12.2016.

PAS DHJETORIT 2011

Amnistia parashikon falje, por me kusht, të detyrimeve e gjobave të krijuara nga janari i vitit 2012. Sipas përcaktimit në draft "Detyrimet tatimore të papaguara (tatimin/kontributin/taksën, kamatvonesën dhe çdo dënim administrativ të lidhur me një lloj tatimi/takse/ kontributi ose jo), që u përkasin periudhave tatimore duke filluar nga janari 2012, të evidentuara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, falen nëse tatimpaguesi brenda datës 31.03.2017 paguan 70% të tatimit/taksës dhe kamatvonesës përkatëse". Dënimet administrative (gjobat) për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të personave fizikë dhe juridikë, që janë të evidentuara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji dhe i përkasin periudhës pas dhjetorit 2011, falen me kushtin që kontributi i paguar dhe kamatvonesat përkatëse pavarësisht periudhës që i përket, të paguhet brenda datës 31 mars 2017.

Dënimet administrative i nënshtrohen



faljes sipas kësaj pike me kushtin që të jenë të evidentuara ose të regjistruara në llogarinë e tatimpaguesit deri në datën 31 korrik 2016.

Dënimet administrative (gjobat) që nuk aplikohen mbi një lloj tatimi/kontributi/takse të papaguar, të cilat janë dënime për kundravajtje administrative tatimore si dënime pa tatim, ose dënime të aplikuara sipas ligjeve të veçanta tatimore, që u përkasin periudhave tatimore duke filluar nga janari 2012, të evidentuara ose regjistruara në llogarinë e tatimpaguesit deri në datën 31 korrik 2016.

Me qëllim përfitimim e faljes së gjobave për këtë pikë, kushti i pagesës së detyrimit tatimor të papaguar prej 70%, llogaritet dhe zbatohet mbi vlerën totale të tatimit dhe kamatvonesës, për të gjitha detyrimet që i përkasin të njëjtit tatimpagues.

NË FOTO: Faksimile e projektligjit mbi amnistinë fiskale për bizneset dhe qytetarët

NDARJA

Koha kur Tirana ndahej në qendër dhe në periferi, në autoktone dhe në të ardhur, në zona të urbanizuara dhe zona informale, duhet të marrë fund

MOTIVACIONI

“Sa më shumë punë, sa më pak fjalë, sa më pak sherre dhe sa më shumë rezultate konkrete. Kjo është mënyra se si Tirana ecën përpara”

Punimet për rrjetin e ujësjellësit, Veliqaj: Kurseni ujin

Bashkia dhe UKT nisën investimin për shtrirjen e rrjetit të ri të ujësjellësit në Njësinë 4

Rreth 12 mijë banorë në periferi të Tiranës nuk do të kenë më probleme me furnizimin me ujë të pijshëm. Bashkia e Tiranës dhe UKT nisën investimin për shtrirjen e rrjetit të ri të ujësjellësit në zonën që kuqizohet nga rrugët “Myslym Keta”, “Shefqet Kuka” dhe “Thoma Filipi” në Njësinë Administrative nr. 4, e cila i jep zgjidhje problemit të ujit të pijshëm i mbaruar prej vitesh. Punimet u ndoqën nga afër sot nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliqaj, deputeti i PS, Xhemal Qefalija, si dhe drejtori i UKT-së, Redi Molla. Pasi u njoh me projektin dhe volumin e punës, kryebashkiaku Veliqaj tha se ky investim i jep zgjidhje një kërkesë të vazhdueshme të banorëve të kësaj zone, të cilët prej vitesh vuanin nga mungesa e ujit. “Një nga kërkesat kryesore të banorëve të zonës ka qenë nevoja për furnizim me ujë të pijshëm dhe më cilësor. Besoj se ky investim i plotëson të gjitha këto nevoja. Koha kur Tirana ndahej në qendër dhe në periferi, në autoktone dhe në të ardhur, në zona të urbanizuara dhe zona informale, duhet të marrë fund. E vetmja mënyrë se si merr fund nuk është me fjalime, por duke bërë investime të tilla, që sjellin urbanizim. Nuk besoj se ka investim që sjell më shumë qytetërim se sa të pasurit ujë të pijshëm”, tha Veliqaj. Ai theksoi se bashkia synon që investimi të përfundojë në kohë rekord dhe me cilësi të lartë punimesh. “Lajmi i mirë është që këtë verë, tekta banorët e kësaj zone shkojnë me pushime, bashkia do të vijojë punën, që kur ata të kthehen nga pushimet, investimi të ketë mbaruar, në mënyrë që 12 mijë familje, jo vetëm të kenë ujë me periudha më të gjata kohe, por sigurisht edhe ujë më cilësor”, shtoi Veliqaj. Gjithashtu, ai shtoi se ky investim është një dëshmi e përkushtimit dhe kujdesit të Bashkisë së Tiranës që në këtë vit të parë emergjente të bëjë çdo ditë nga punë, për t'i dhënë zgjidhje problemeve më urgjente të qytetarëve të Tiranës. “Kjo është puna konkrete e ditës së sotme dhe besoj se mesazhi që kemi marrë është: sa më shumë punë, sa më pak fjalë, sa më pak sherre dhe sa më shumë rezultate konkrete. Kjo është mënyra se si Tirana ecën përpara. Jemi krenarë që vijmë pas i viti para banorëve me

një premtim të mbajtur, por duhet të pranojmë që ka ende shumë për të bërë”, tha ai.

THIRRJA

Ai shfrytëzoi rastin që, në këto ditë të nxehta të verës, kur edhe burimet pakësojnë prurjet, t'u bëjë thirrje qytetarëve të bëjnë më shumë kujdes në përdorimin e ujit dhe të mos abuzojnë me të. “I ftoj qytetarët që ta kursejmë ujin e pijshëm, është një mall që kushton dhe është e papranueshme që në pikun e verës, vazhdojmë të përdorim ujë të pijshëm në lavazhe për të larë makina, për të ujtur e vaditur. Ndaj jemi treguar jashtëzakonisht të rreptë dhe do të vazhdojmë të jemi të rreptë

më këdo që shpërdoron ujin. Nuk e bëjmë këtë sepse u kemi shpallur luftë lavazheve, por sepse na dhimbën qytetarët që duan ujë”, deklaroi Veliqaj, ndërsa kërkoi nga qytetarët që të denoncojnë çdo ndërhyrje të paligjshme dhe keqpërdorim të ujit të pijshëm.

DEPUTETI QEFALIA

Ndërkohë, deputeti i PS, Xhemal Qefalija falenderoi Bashkinë e Tiranës për vëmendjen e kthyer në këtë zonë, duke theksuar se rrjeti i ri i ujësjellësit është një investim i kërkuar me ngulm nga banorët e gjithë kësaj zone. “Ka mbaruar ankthi i ujit të pijshëm. Ky është një investim që bëhet në pikun e nevojës




Erion Veliqaj inspektori punimet e UKT në njësinë nr.4

për ujë dhe shpresoj që të vazhdojë. Këtu nuk është vetëm për banorët e kësaj zone, por ky investim mbush edhe një depo kryesore në pjesën e Freskut, gjë që do të përmbushë ato kërkesa që kanë banorët”, u shpreh Qefalija. Punimet për linjën e re të ujësjellësit në këtë zonë do të kryhen në dy lote, ku loti i parë përfshin zonën midis rrugëve “Gaqo Vakeli”, “Abaz Dojaka”, “Shefqet Kuka” dhe “Andon Kuqali”. Me anë të këtij investimi UKT synon t'i japë fund problemeve të furnizimit me ujë, si dhe ndërtimit të një rrjeti komplet i ri sipas të gjitha standardeve duke eliminuar në këtë mënyrë edhe shtrimet e paligjshme që janë gjetur si zgjidhje e përkohshme nga banorët.

UJËSJELLËSI

Qyteti i Durrësit pa ujë të pijshëm, defekte në rrjetin shpërndarës



Qyteti i Durrësit nuk është furnizuar me ujë të pijshëm gjatë gjithë ditës e djeshme dhe shkak për këtë situatë janë bërë defektet e shkaktuara në rrjetin shpërndarës të ujësjellës kanalizimeve. Nga mëngjesi deri rreth orës 18.00 janë riparuar 10 defekte në pjesë të çara të tubit në zonën e Sukthit dhe Shkafanës, ndërkohë që janë edhe 8 të tjera për tu riparuar në zonën pranë rezervuarit të Tarinit. Në këtë zonë paraqitet vështirësia më e madhe pasi aty tubacioni gjendet mes një pylli dhe UKD është detyruar që të hapë një rrugë pasi nuk ka një të tillë për të shkuar fadromat në vendin ku është shfaqur defekti. Nga ana tjetër punimet po kryhen në një zonë kënetore që sjell përsëri vështirësi në përfundimin e defekteve në një kohë sa më të shpejtë. Ujësjellës Kanalizime Durrës është duke punuar me intensitet të lartë për të rikthyer në normalitet furnizimin me ujë të qytetit të Durrësit. Në zonën ku tubacioni kryesor me diametër 700 mm ka pësuar çarje kanë punuar 3 grupe saldimi, ndërkohë që për riparimin e defekteve UKD ka vënë në dispozicion 3 fadroma, 2 kamionë dhe 2 karro-oficina. Gjithsesi brigada e аварие me 22 persona në total po punon maksimalisht që gjatë mbrëmjes së sotme të riparohen edhe defektet e mbetura dhe të lëshohet uji.

RREGULLORJA / IDENTIFIKIM ME SAKTESI I MONEDHAVE

Bankat do instalojnë makina për monedhat false metalike

Të gjitha bankat tregtare, ashtu dhe subjektet e licencuara në veprimtari financiare do të jenë të detyruara të instalojnë pajisje që dedektojnë monedhat metalike false. Rregullorja e re e Bankës së Shqipërisë për trajtimin e monedhave detyron këto subjekte të identifikojnë në kohë dhe të mos riqarkullojnë monedhat false, por edhe të identifikojnë peronat që i dorëzojnë ato. Sipas rregullores, makinat duhet të përpunojnë monedhat metalike lek, duke klasifikuar dhe veçuar fizikisht monedhat metalike të përshtatshme për qarkullim nga ato të dyshuara të falsifikuara dhe/ose të papërshtatshme për qarkullim pa ndërhyrjen e faktorit njeri (operatorit). Po njëherësh duhet të përshtaten për të siguruar identifikimin me saktësi dhe veçimin e monedhave metalike të falsifikuara të reja.



DETYRIMET

Rregullorja detyron subjektet të identifikojnë në kohë dhe të mos riqarkullojnë monedhat false, por edhe të identifikojnë peronat që i dorëzojnë ato.

DEPOZITAT

Kursimet e shqiptarëve drejt fondeve të investimit

Rënia e interesave të depozitave bankare po drejton qytetarët që kursimet e tyre t'i përdorin për produkte të tjera financiare, siç janë fondet e investimeve. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare raportoi në Komisionin e Ekonomisë se për 2015 fondet e investimeve u rritën 5,1 përqind me një vlerë prej rreth 67 miliardë lekësh. “Kjo tregon interesin që kanë investitorët vendas për produkte të reja kursumi apo investimi. Një situatë e tillë favorizohet edhe nga mjedisi me norma të ulta interesat që zbatohen bankat”, tha Shehu, kryetare e AMF.



Kryeministri Rama shpërndan në Shijak 1001 leje legalizimi

“PD në 8 vjet ka bërë vetëm 7 legalizime dhe asnjë nga banesat nuk është për familje”

Kryeministri Edi Rama shpërndau sot 1001 certifikata legalizimi në Bashkinë e Shijakut. Në fjalën e tij, kryeministri tha se në një muaj, ALUIZNI arrin të përmbyllë 4500-5000 legalizime. Ai theksoi se PD në 8 vitet e pushtetit, ka legalizuar në Shijak vetëm 7 objekte. “Sot, kur më thanë që organizohej ky takim, do të kishte pasur një debat midis Artan Lames dhe kabinetit tim, për shkak se ju e dini që tani janë disa ditë shumë të rëndësishme dhe një problem shumë i madhor. Unë i thashë do të shkoj në Shijak dhe realisht jam shumë i kënaqur e ndihem shumë mirë kur vij këtu. Sidomos nuk doja të humbja rastin për ta parë këtë transformim të jashtëzakonshëm të qendrës së qytetit tuaj, në praninë tuaj dhe për t’ju siguruar që kjo punë do të vazhdojë. Në 8 vjet, Partia Demokratike bëri vetëm 7 legalizime. Në një zonë ku PD s’është trajtuar keq, ka pasur mbështetje, demokratë e simpatizantë që i kanë dhënë jo pak PD-së. Por PD në 8 vjet ka bërë vetëm 7 legalizime dhe asnjë nga banesat nuk është për familje, por

Krahasimi

“Ritmi aktual i legalizimeve, tha Rama, është 4500-5000 legalizime në muaj. Me këtë ritëm, ne në gjithë Shqipërinë legalizojmë në katër muaj çfarë ka lëvizur PD në pushtet. Dhe çdo 4 muaj sa për 8 vjet të tyre”

5000 legalizime

Zyrat e ALUIZNI-t përfundojnë rreth 5000 legalizime në muaj, falas, duke bërë përfundimisht pronarë të banesave të tyre, mijëra familje që prej dekadash janë sorollatur dhe lënë në harresë

Qytetarët

Kur thatë se do ndani 1001 leje legalizimi nga ky shesh, kjo nuk është përrallë si e 1001 netëve, por është realitet. Ju e bëtë realitet në këtë shesh, për të cilën ju falenderoj” – u shpreh Avni Khafa



janë restaurante. Ndërkohë që njerëzit janë zvarritur. Sot ndajmë 1001 leje legalizimi, që do të thotë se nga ky shesh dalin sot pronarë të shtëpisë së tyre me dokumente në dorë”, u shpreh Rama. Ai theksoi se në Shijak mbeten pa legalizuar edhe 250 objekte. “Nga ana tjetër, mbeten dhe rreth 250 objekte që duhen legalizuar. Historia e legalizimit ka qenë ec e gjej pengesa”. Ritmi aktual i legalizimeve, tha Rama, është 4500-5000 legalizime në muaj. “Me këtë ritëm, ne në gjithë Shqipërinë legalizojmë në katër muaj çfarë ka lëvizur PD në pushtet. Dhe çdo katër muaj sa për 8 vjet të tyre”, tha Rama.

ALUIZNI

Zyrat e ALUIZNI-t përfundojnë rreth 5000 legalizime në muaj, falas, duke bërë përfundimisht pronarë të banesave të tyre, mijëra familje që prej dekadash janë sorollatur dhe lënë në harresë. Ecuria e mirë e procesit të legalizimit u evidentua sot nga Kryeministri Edi Rama, në një takim me banorë të Shijakut, ku u shpërndanë 1001 certifikata legalizimi. Me administrimin e ri të ALUIZNI-t është arritur që në katër muaj, numri i objekteve të legalizuara të jetë i barabartë me legalizimet e bëra në katër vite të qeverisjes së kaluar. Në Shijak,

në tetë vitet e qeverisjes së kaluar ishin legalizuar vetëm shtatë objekte dhe të shtata restaurante dhe asnjë shtëpi. Një fakt ky i nënvizuar edhe nga vetë ata që sot u bënë pronarë të shtëpisë së tyre. “Faleminderit se deri tani ishim në ajër, tani u bëmë me pronë, me shtëpi”, – tha Gëzim Domi. “Ju falenderoj shumë, sepse kishim fiks 11 vite që e kërkonim dhe nuk na e jepnin”, – tha ndër të tjera Gëzim Senjari. “Kemi kaq vjet që ne mundohemi për një letër. Edhe këta të ALUIZNI-t na kanë ndihmuar pa asnjë kacidhe”, – tha një tjetër qytetare.



RESTAURIMI

Turizmi, Pazarit i Korçës i rikthehet aktivitetit për bizneset



Pas punimeve për restaurimin e pazarit të vjetër të Korçës, dyqanet dhe hanet do të rinisin aktivitetin për ta kthyer këtë pjesë të qytetit në lavidinë e dikurshme. Përmes projektit për rijetëzimin e pazarit, Bashkia e Korçës ka hapur rrugën për zhvillimin e bizneseve të ndryshme, çka pritet ta kthejë atë në një pol zhvillimi ekonomik-turistik. Për shumë biznese të cilat do të zhvillojnë aktivitetin e tyre në ambientet e këtij pazari, bashkia ka hapur edhe një fazë aplikimesh duke ofruar mbështetjen në disa drejtime. “Duam që pazari të jetë një pol i rëndësishëm i aktiviteteve ekonomike me fokus turizmin, prandaj kemi prezantuar një paketë të plotë të mbështetjes për ato biznese që do të duan të ushtrtojnë aktivitetin e tyre në pazarin e Korçës”, ka deklaruar kryebashkiaku Sotirraq Filo. Pas përmbylljes së fazës së aplikimeve më 26 korrik do të përzgjidhen edhe bizneset të cilat do të operojnë në dyqanet e pazarit dhe hanet e njohura, të cilat do të kthehen në funksionin e tyre të plotë.

SEMUNDJA

Antraksi, vaksinimi pasi shfaqet. ISHP: Ka mungesë koordinimi

Silva Bino, shefe e Departamentit të Sëmundjeve Infektive në ISHP



është identifikuar një vatrë e infektuar. Ndërkohë, nuk funksionon si duhet as koordinimi ndërmjet strukturave të veterinarisë dhe atyre të shëndetësisë. “Kjo është një mangësi që ne nuk marrim raporte të rregullta në lidhje me vaksinimin e kafshëve. Në bazë të ligjit të ri, shërbimi veterinar duhet të raportojë rastet me antraks brenda 24 orëve”, thotë Bino. Sipas Binovos janë marrë masa për të mos lejuar përkeqësimin situatës tek familjarë të tjerë të qytetarit që humbi jetën nga antraksi.

Analizat laboratorike në Institutin e Shëndetit Publik kanë konfirmuar se 56-vjeçari nga Libohova ka humbur jetën i prekur nga antraksi, apo siç njihet në gjuhën popullore, plasja. Antraksi është një sëmundje e rrezikshme, e cila nuk transmetohet vetëm nga konsumi i mishit të infektuar. “Një person që mund të jetë gërvishur dhe

të infektohet me spore, ose kur ther bagëti të sëmura, nga kjo shfaqet antraksi cutan. Kemi patur raste kur është transportuar edhe përmes mizave”, thotë Silva Bino, shefe e Departamentit të Sëmundjeve Infektive në ISHP. Pranë ISHUV është marrë një mostër e mishit të kafshës që ishte në frigoriferin e familjarëve për të vërtetuar nëse është prekur nga konsumi i mishit, ndomëse specialistët janë skeptikë për këtë analizë. Libohova në Gjirokastër dhe disa zona në Sarandë konsiderohen vatra të antraksit prej vitesh, por ajo që e bën më shqetësues situatën dhe që e konfirmojnë edhe burime nga Ministria e Bujqësisë është se kafshët nuk vaksinohen më parë me qëllim parandalimin, por vetëm pasi

VALUTA

Euro në rënie, niveli më i ulët në katër vitet e fundit

Siaps kursit zyrtar të këmbimit valutor një euro u këmbye me 136.48



Monedha vendase, leku u forcua ndjeshëm ndaj monedhës së përbashkët euro. Siaps kursit zyrtar të këmbimit valutor të Bankës së Shqipërisë një euro u këmbye me 136.48, që sipas ekspertëve të agjencive të këmbimit valutor në Tiranë është një nivel historik, më i ulët i arritur që nga gushti 2012 kur një euro u këmbye me afërsisht 136.5 lekë. Megjithatë ekspertët e vlerësojnë si një sjellje normale rënien e euros (përpas faktit që ka kapur një nivel historik). Sipas tyre

kjo sjellje e euros ndaj lekut ka tre arsye bazë. E para ka të bëjë me sezonalitetin e pushimeve. Pas mbylljes së muajit të Ramazanit, është rritur ndjeshëm numri i turistëve nga Kosova dhe nga Maqedonia që kanë zgjedhur të pushojnë në vendin tonë. E dyta ka të bëjë me faktin se kompanitë janë në periudhën kur duhet të shlyejnë

detyrimet e pagesës së TVSH-së dhe në kushtet kur kanë mungesë likuiditeti janë të detyruar që të prekin rezervat në euro. E treta ka të bëjë me punimet për realizimin e projektit të gazsjellësit TAP, çka nënkupton se është rritur angazhimi i firmave shqiptare që punojnë si nënkontraktorë. Sipas tyre këto janë tre faktorët bazë që kanë ndikuar në kuotimin historik të euros kundrejt lekut. Ata thonë se është e vështirë që të bëhet një parashikim nëse kjo tendencë do të vazhdojë gjatë, megjithatë thonë se mund të kemi Hulajetë të tilla deri në pjesën e dytë të muajit gusht. Sa i përket kursit të këmbimit të lekut me monedhën britanike, pand ata thonë se sjelljet diktohen kryesisht nga raportit me paundit dhe euros, si dhe për faktin se britanikët janë më të interesuar për një paund të zhvlerësuar.

Abonohu!



[SHQIPTARJA.com]

origjina e lajmit...



Për t'u abonuar ju lutemi kontaktoni me:

👉 **POSTA SHQIPTARE**
 Tel: 042 375 598 ; 04 237 55 98 ; Cel: 066 20 17 771
 abonime@postashqiptare.al

👉 **AGJENCIA E ABONIMIT TË SHTYPIT**
 Tel: 04 422 11 08; Cel: 066 20 47 825
 arben.trenova@yahoo.com

👉 **ADRION LTD** telecom
 Tel: 04 22 40 018; Cel: 069 40 36 824
 sales@adrionltd.com

Gjermani: Brenda vitit 2016, 26 bashki me plane gati

Objektivi final është që jenë të hartuara dhe të miratuara Planet e Përgjithshme

Brenda këtij viti, 26 bashki do të ketë të hartuara dhe të miratuara Planet e Përgjithshme vendore. Ky është objektivi final për Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, të cilat po monitorojnë procesin e hartimit të 26 PPV, të mbështetura financiarisht e teknikisht nga Qeveria, me një fond prej 560 milion lekësh. Ministria Eglantina Gjermani gjatë takimit të drejtues të 26 bashkive dhe përfaqësues të studiove vendase dhe të huaja, që kanë punuar për këto plane theksoi se, brenda vitit 2016 duhet të finalizohet procesi i hartimit, diskutimit në publik dhe miratimit në Këshillat Bashkiakë, e më pas miratimi në Këshillin Kombëtar të Territorit të planeve vendore. “Duke mirëkuptuar faktin, që hartimi i PPV u bë në një kohë relativisht të shkurtër, si dhe duke besuar fort se, të gjitha dokumentat që ju keni draftuar duhet të diskutohen në publik me grupet e interesit, për të qenë pjesë e debateve kemi vendosur shtyrjen prej 6 javësh të afatit, për dërgimin për miratim të draft – planeve. Ky është maksimumi i mundshëm, që ne mund t’ju ofrojmë për hir të interesit publik dhe kjo për faktin se, jo thjesht është detyrim ligjor, por sepse ne vërtetë besojmë se procesi për hartimin dhe miratimin

OBJEKTIVI

Gjermani theksoi se brenda vitit 2016 duhet të finalizohet procesi i hartimit, diskutimit në publik dhe miratimit në Këshillat Bashkiakë, e më pas miratimi në Këshillin Kombëtar të Territorit të planeve vendore

e këtyre planeve duhet të jetë gjithëpërfshirës, transparent dhe të paraqesë nevojat dhe interesat e qytetarëve”, tha Ministria Gjermani në fjalën e saj.

KËRKESA

Ministria Gjermani kërkoj në mënyrë të veçantë përfshirjen në të gjitha hallkat e procesit të anëtareve të këshillave bashkiakë. “Pavarësisht situates aktuale politike, me gjithçka po



SITUATA

“Pavarësisht situates aktuale politike, me gjithçka po ndodh këto ditë me reformën në drejtësi, unë lutem që të mos e reflektoni këtë situatë në punën për përfundimin e planeve vendore.”

ju përfaqësoni, janë baza për një zhvillim të mirëmenaxhuar. Anëtarët e këshillave bashkiakë duhet t’i bëni pjesë të procesit, të diskutimeve, që në momentin që planet vendore të prezantohen në këto këshilla të keni mbështetjen dhe votën e tyre”, deklaroi Ministria në takimin me drejtuesit e bashkive dhe studiit.

MARRËVESHJET

Në Janar të këtij viti u firmosën marrëveshjet për



Eglantina Gjermani

hartimin e planeve vendore mes MZHU, studiove fituese vendase dhe ndërkombëtare si dhe 26 bashkive: Lezhë, Kurbin, Krujë, Kukës, Durrës, Vorë, Shijak, Kavajë, Rrogzhiinë, Divjakë, Ura Vajgurore, Polican, Skrapar, Gjirokastrë, Vlorë, Himarë, Sarandë, Konispol, Librazhd, Përrenjas, Cërrik, Pogradec, Korçë, Tiranë dhe Shkodër. Këto bashki përfitojnë asistencë financiare dhe teknike nga buxheti i shtetit për har-

timin e Planeve të Përgjithshme Vendore. Ndërkohë, 5 bashki të tjera: Fier, Lushnjë, Berat, Kuçovë dhe Elbasan po asistohen nga USAID për planet vendore. Pak javë më parë, Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp) financiar nga Qeveria Zvicerane i është përgjigjur interesimit për asistencë financiare dhe teknike për bashkinë e Malësisë së Madhe, në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.

UDHËZIMI/ ZV/MINISTRJA NORA MALAJ SQARON PROCEDURAT

Universitetet, aplikimi online fillon në fund të korrikut

NORA MALAJ



Sipas Nora Malajt, afati i aplikimit në universitet u shty për në fund të muajit korrik, për shkak të disa problemeve teknike që kanë ardhur nga sekretimi i provimeve të maturës, pasi në disa raste nuk është përpunur kodet me emrin

Aplikimi për të fituar të drejtën e studimit në një nga programet që ofrohen nga 34 institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat, do të fillojë në fund të muajit korrik. Për herë të parë pjesë e aplikimit veç 12 universitete publike do të bëhen edhe 22 universitet private. Maturantët këtë vit do të aplikojnë nëpërmjet formularit të aplikimit, ku do të kenë të drejtën të regjistrohen në 10 programe studimi. Ndryshe nga formulari 2, ku kishte shumë rëndësi renditja e preferencave, në këtë formular renditja e 10 degëve që preferon kandidati nuk kanë rëndësi. Sipas zv.ministres së Arsimit, Nora Malaj, draftudhëzimi është dërguar për diskutim në institucionet e arsimit të lartë dhe më pas të miratohet. Në lidhje me kuotat, ajo ka sqaruar se “kuotat e miratuara nga senatet e universiteteve janë përfundimtare, nuk do miratohen më nga qeveria”.

APLIKIMI ONLINE

Sipas zv.ministres, Nora Malaj, afati i aplikimit në universitet u shty për në fund të muajit korrik, për shkak të disa problemeve teknike që kanë ardhur nga sekretimi i provimeve të maturës, pasi në disa raste nuk është përpunur kodet me emrin e maturantit si dhe hedhja në sistem e të dhënave dhe të maturantëve të



shkollave profesionale. Ndaj për këto arsye në shkollat e mesme vijohet të hidhen në sistem të dhënat e maturantëve, përgjatë tri viteve. Edhe pse afati i fundit në rregulloret të Maturës Shtetërore është përcaktuar data 15 korrik. “Brenda datës 15 korrik, të gjithë maturantët që duan të vazhdojnë studimet duhet të plotësojnë bazën e të dhënave për të gjitha vitet e shkollës së mesme” përcaktohet

në pikën 8, neni 10 të Rregullores së Maturës Shtetërore 2016. “Aplikimi në universitetet publike dhe private do të bëhet online nëpërmjet formularit të aplikimit, në bazë të grafikut të datave që do të përcaktohen për çdo DAR/ZA”, theksoi Malaj. Sa i përket tarifës që do të duhet të paguajnë maturantët për aplikim ajo do jetë 2 mijë lekë. “Plotësimi i formularit të aplikimit, ashtu si është vepruar vitet

FORMULARI

Formularin e aplikimit kanë të drejtë ta plotësojnë të gjithë maturantët që kanë kaluar me sukses provimet e Maturës Shtetërore 2016, si dhe kandidatët e viteve të mëparshme që kanë plotësuar formularin A1Z

e tjera me plotësimin e formularit A2, do jetë kundrejt një pagese prej 2 mijë lekësh”, sqaroi Malaj. Sipas zv.ministres aplikimi do të kryhet në fund të muajit korrik, pasi Agjencia Kombëtare e Provimeve të ketë hapur portalin “matura shtetërore online”. Formularin e aplikimit kanë të drejtë ta plotësojnë të gjithë maturantët që kanë kaluar me sukses provimet e Maturës Shtetërore 2016, si dhe kandidatët e viteve të mëparshme që kanë plotësuar formularin A1Z. Po ashtu, sistemi automatik skualifikon aplikantët që nuk kanë mesataren 6 apo një mesatare të dytë për degë specifike të miratuara nga vetë universitetet. Nëse maturanti aplikues e ka mesataren e futur në sistem nga sekretaritet mësimore të shkollave të mesme më të vogël se 6.0, atëherë ai mund të përzgjedhë vetëm programet e studimit dyvjeçar (profesionale) që ofrohen nga disa universitete shtetërore dhe private, në bazë të vendimit të qeverisë. Pas aplikimit në portal, AKP u përcjell universiteteve numrin dhe gjatë të dhënat e aplikuesve për secilin degë. Ajo çfarë bëjnë universitetet në këtë moment është publikimi i listës së aplikantëve. Një vijë e kuqe përcakton fituesit e fazës së parë të cilët do të kenë 7 ditë kohë të bëjnë regjistrimin me dokumentacion në universitet.



Faktet

Janë pikërisht faktet e vërteta të historiografisë bashkëkohore që lejojnë sot të shihet qartë në të shkuarën e largët e të afërt të këtij vendi e të shpallë se Epiri nuk qe kurrë grek



DOKUMENTET 1941

“EPIRI NUK KA QENE KURRE GREK”, JA ARGUMENTET DHE FAKTET HISTORIKE

KUR PROJEKTOHEJ SHQIPËRIA ETNIKE/ Pjesa e dytë e dokumentit të majit 1941 “Përkujtesë, përshpagimet shqiptare”, dërguar mëkëmbësit të mbretit jakomonit nga komisioni i përbërë nga Fejzi Alizoti, Dhimitër Berati, Xhemil Dino, Tahir Shtylla e Mustafa Kruja...

ADMIRINA PEÇI
TIRANE

(Vijon nga dje...)

Në fillim të vitit 1941 Jakomoni, Mëkëmbësi i Mbretit, kërkonte nga Qeveria shqiptare një paraqitje të hollësishme të problemit të kufijve shqiptarë e të territoreve që, për arsye të ndryshme, duhej të ishin pjesë e Shtetit shqiptar në kuadrin e Perandorisë së Romës. Pas kësaj qeveria e Verlacit kishte ngritur një Komision, në nivel të lartë politik e studiuesish, për të përgatitur këtë material, që do t'i përcillej Ministrisë së Jashtme e do të përbënte bazën politike të kërkesave shqiptare. Komisioni hartues i këtyre dokumenteve përbëhej nga Fejzi Alizoti, Dhimitër Berati, Xhemil Dino e Tahir Shtylla e kryesohet nga Mustafa Kruja, atëherë senator i Mbretërisë e Kryetar i Institutit të Studimeve shqiptare... Në maj të 1941, komisioni kishte parashtruar të gjithë argumentet mbi projektin e Shqipërisë etnike. Dokumenti ishte ndërtuar mbi disa anekse dhe mban titullin “Përkujtesë, përshpagimet shqiptare”. Dje botuam një pjesë nga ky dokument voluminoz ku trajtoheshin kryesisht çështjet që lidhen me Greqinë dhe Çamërinë. Nga kjo temë sjellim sot pjesën e dytë të argumentit mbi Çamërinë, si dhe një letër shoqëruese të Rauf Ficos dërguar kryeministrit Verlaci ku e vë në dijeni për punën që po bënte komisioni. Më poshtë sjellim pjesën e dytë të dokumentit që nisëm të botojmë dje ku trajtohen çështjet historike të Epirit dhe këtë letër të Rauf Ficos.

Megjithatë për një vëzhgues të kujdesshëm arsyet e sipërpërmendura nuk kanë asnjë vlerë, mbasi vetë Greqët në lashtësi, siç kemi parë, njëzëri i kanë quajtur epirotët si “barbarë”, pra jo Greqë por të huaj. Kërkimet më të fundit mbi historinë bizantine kanë vërtetuar se formacionet politike t’Epirit, principata ose despotate, me përjashtim të etiketave nuk paraqesin asnjë karakteristikë tjetër greke. Po ashtu mund të pohohet, pa frikë gabimi, se herojtë e pavarësisë greke, suliotët, ishin thjesht shqiptarë ortodoksë, që mezi e kuptonin gjuhën greke. Sidoqoftë propaganda greke ka bërë aq shumë dhe është vërtitur aq mirë sa opinioni i remë mbi karakterin grek të Epirit arriti të përhapet, në sajë të pohimeve të vazhdueshme të politikanëve grekë që nuk njihnin historinë, të historianëve që deshën të vihen në shërbim të politikës e së fundi, në sajë të atyre që, të dehur me klasicizëm, me qëllim kanë ngatërruar fantazitë mitologjike me realitete historike të vërtetuara.

Janë pikërisht faktet e vërteta të historiografisë bashkëkohore që lejojnë sot të shihet qartë në të shkuarën e largët e të afërt të këtij vendi e të shpallë se Epiri nuk qe kurrë grek, as nga pikpamja historike dhe as nga ajo teknike.

Politikisht Greqia, që kishte rrembyer më 1881 rrethin e Artës, vetëm më 1912 arriti të



Fejzi Alizoti



Xhemil Dino

bashkangjisë pjesën tjetër t’Epirit, deri në kufirin me Shqipërinë. Kjo pjesë e gjallë e territorit kombëtar shqiptar i u dhurua Greqisë nga demokracitë e mëdha, që shpesh kanë flijuar fatin e popujve në të njëjtin çast, në të cilin shpalleshin mbrojtës të tyre dhe të parimit të kombësisë. Epiri, si shumë qoshe të tjera të truallit shqiptar, është tregëtar më shumë se një herë për të plotësuar lakmitë e Greqisë në Kongresin e Berlinit më 1878, në Konferencën e Londrës më 1913, dhe në Konferencën e Paqes së Parisit (1919). Të tre këto data kanë qënë ogurzeza për kombin shqiptar, nga trupi i të cilit xhvateshin pjesë të gjalla për t’u a dhënë shteteve fqinjë si çmim për fitoret e arritura kundër të tjerëve në luftëra, në të cilat Shqipëria nuk kishte të bënte për asgjë.

Por tashmë ora e shlyerjes së llogarive ka mbërritur. Paqja me drejtësi nënkupton rishikimin e të gjithë padrejtësive që kanë shkaktuar konfliktin e sotëm. Si pasojë, sektori ballkanik, kjo pikë nevalgjike e Evropës, duhet të gjejë në rindin e ri rregullimin e tij përfundimtar, të bazuar mbi njohjen e të drejtave të gjithë popujve që e banojnë, në përputhje me parimet e zbatuara nga rendi i ri i sotëm.

Me besim të plotë në të drejtën e saj për të fituar atë që i takon, Shqipëria, e ndërgjegjeshme se është pjesë e gjallë në kuadrin e Perandorisë së Romës, nuk dëshiron tjetër veçse të rimarrë atë që, padrejtësisht, i është hequr.

Për këtë qëllim paraqesim më poshtë, në pikat themelore, arsyet për të cilat Epiri duhet të quhet pjesë e pandarë e Shqipërisë.

1 – Epiri, që shtrihet nga kufiri i sajaur i Sh-



Padrejtësia

Shqipëria, e ndërgjegjeshme se është pjesë e gjallë në kuadrin e Perandorisë së Romës, nuk dëshiron tjetër veçse të rimarrë atë që, padrejtësisht, i është hequr.

gjitha kryengritjet kundër zgjedhës turke e të gjitha ngjarjet politike të Epirit kanë thjesht vullë shqiptare. Po sjellim dy shembuj : a) Shpallja e vullnetit për pavarësi të popullit shqiptar nën drejtimin e Ali Pashë Tepelenës, që pati qendrën kryesore Janinën, në tokën e Epirit ; b) Luftërat e popullit shqiptar, të bashkuar në lidhjen e Prizrenit, që arritën të shpëtonin Epirin nga bashkimi me Greqinë, e cila mundi të marrë atëherë vetëm rrethin e Artës (1881).

Humbja e këtij rrethi e, mbi të gjitha, bashkimi me Greqinë i një pjese të Vilajetit të Janinës, përfshirë Prevezën dhe Çamërinë më 1912, cilësohen si akte grabitjeje në dëm të bashkimit dhe tërësisë së Shqipërisë.

4) – Nga pikpamja kulturore Epiri i lashtësisë pëson ndikimin grek, veçanërisht atë të Korfuzit e të Korintit, më pas atë të Romës. Të dy këta ndikime ushtrohen në brigjet ose gjatë rrugëve të rëndësishme të komunikacionit, por janë sipërfaqësore. Gjatë epokës mesjetare Epiri bie në kontakt me kulturën bizantine dhe disa edhe me atë të Perëndimit, por kjo nuk prek masën e popullit që vazhdon të ruajë veçoritë e tij të trashëguara.

Vetëm gjatë pushtimit turk popullsia ortodokse e Epirit u gjend nën pushtetin e ndikimit të Kishës e të shkollave greke. Shqiptarët dhe Vllahët n'Epir nuk mund të zgjidhnin, sepse Turqit nuk pranonin për popullsinë ortodokse të tjera institucione fetare e shkollore, jashtë atyre greke që, siç kemi parë, shërbenin si vegla të shkëmbëtarizimit të elementëve ortodoksë shqiptarë e vllah.

Një veprim i tillë u arrit nëpërmjet mësimt dhe përhapjes së gjuhës greke në dëm të të folmeve kombëtare. Me Kishën dhe shkollën propaganda panhelenike arriti të përhapë, deri në një farë mase, ndjenjat helenike ndërmjet elementëve jo grekë, por bëhet fjalë për një bojatisje të hollë që nuk ka prekur fare strukturën kombëtare. E tani që, së fundi, gjithë Epiri është liruar nga ndikimi dhe zotërimi grek, popullsia e tij, duke u kthyer në bashkëpunim me vëllezërit shqiptarë, shpejt do të ringjallet nga ajo atmosferë e mjegulltë e propagandës greke, për të rimarrë me zjarr shfaqjet e reja të kombësisë së saj.

5) Sa i përket sasisë së popullsisë, simbas një llogarie mjaft të besueshme, mund të pohohet se grekët e të grequarit nuk janë më shumë se 100.000 në numurin e përgjithshëm që arrin në 313.000. Në shifrën e 100.000 janë përfshirë elementët jo vendas që Qeveria e Athinës bëri të derdeshin drejt Evropës mbas 1881 në rrethin e Artës e mbas 1912-ës në pjesën tjetër të vendit të pushtuar. Qëllimi i vendosjes së këtyre elementëve që, dukshëm, ai i të dhënit një shtysë greqizimit të elementëve ortodoksë dhe përzënies, në një mënyrë a tjetër të elementëve myslimanë. Ja një kategori e parë e Epirotëve që duhen kthyer në Greqi. Do të ishte një gabim i rrezikshëm të lejohet qëndrimi në Epir i elementëve epirotë, grekë apo të grequar, të cilët me sjelljen dhe veprimtarinë e tyre, do t'i kishin shërbyer e sigurisht do t'i shërbenin në t'ardhmen, po të mbeteshin, qëllimit të helenizimit. Të tillë elementë do t'ishin, përshembull, autorët e shoqatave politike t'ashtuquajtura "si-logi – epiroti", disa prej mësuesve, priftërinjve, profesionistët, nëpunësit etj., që kanë zhvilluar veprimtari të kundërt me rendin e ri të drejtësisë, që synohet të ndërtohet për elementët kombëtarë, deri tani, të shtypur. Mbasi të jetë çliruar vendi nga këta individë, vegla të shtypjes, që për popullin përfaqësojnë faktorët e një të kaluarë që duhet harruar, masa e madhe e popullsisë epirote, më së fundi e lirë dhe sigurtë, do të kuptojë vlerën e ndryshimit të kryer e mund të gjejë më lehtë rrugën e mirëqënies së saj në Shqipërinë e re.

Fejzi Alizoti, Mustafë Merlika-Kruja, Xhemil Dino, Dhimitër Berati, Tahir Shtylla



DOKUMENTI 2

Rauf Fico: Ja dokumentet që kemi berë gati për Shqipërinë Etnike

Tiranë, me 30 Gusht 1940-XVIII
P. T. KRYEMINISTRISË
TIRANË

Kam nderin të sjell në dijenin e asaj së ndershmes Kryeministrie se punimet e Komisionit të posaçëm për caktimin e kuffijve të Shqipërisë etnike dhe iredente patën si përfundim pregatitjen e një Memoriali mbi rivendikimet shqiptare, redaktuar në italisht prej Zotit Senator Mustafë Kruja dhe të një harte të Shqipërisë së Madhe në shkallën 1/200.000 me kufit e sotme dhe me kufit që caktojnë krahinat e rivendikuara. Memoriali i shkruar në shqip dhe italisht së bashku me hartën në fjalë në tre kopje paraqiten me këtë letër. Memorialin e shoqërojnë dhe anekset përkatëse të shënuara me një pasqyrë të posaçme.

Me këtë rast paraqiten gjithashtu dhe dokumentat që vijojnë : Një memorandum i Ferhat Dragës, ish deputet, dhe i Prof. Momçillo Ivaniç paraqitur Kryeministrit jugosllav Stojadinoviç ; një ankim, paraqitur nga disa Kosovarë Kryeministrit Stojadinoviç ; një parashtrësë paraqitur Kryem. Jugosllav nga 22 deputetë e senatorë të Kosovës ; fjalimi i mbajtur nga deputeti Sherif Voca në parlamentin jugosllav mbi vuajtjet e Kosovarëve. Këto dokumenta janë nxjerrë nga arkiva rezervate e ish – Ministris së P. Të Jashtme.

Paraqitet gjithashtu një hartë etnografike e Prof. J.J. Kettlerit (pron'e zotit Kolea) e cila ka një rëndësi të madhe për çeshtjen që na intereson. Mbas përdorimit që do të shihet i arsyeshm harta në fjalë duhet t'i kthehet pronarit.

Me këtë rast e shohim të ud-

hës të rekomandojmë edhe librin Albanais et slaves (prej Lumo Skendos), që është një studim shumë më rëndësi dhe përmban shpjegimet dhe dokumentat e nevojshme.

Paraqitet gjithashtu libri Kolonizimi i Serbisë Jugore i shkruar prej Këshilltarit Kryesor të Reformës Agrare jugosllave Gjergj Krstiq, që i është ngjitur si aneks Nr. 3 Memorialit dhe meriton të përkthehet në shqip mbasi tregojnë qëllimet e kolonizimit jugosllav në Kosovë.

Paraqitet edhe një koleksion hartash, pron'e Zotit Ingj. Zyma, të cilat do t'ishin mirë t'i jepesh urdhër të vazhdojë punimin e filluar për plotësimin e një harte të madhe të Shqipërisë etnike.

Midis hartave të ndryshme që paraqiten ndodhen riprodhimet e hartës së kolonizimit jugosllav në Kosovë dhe riprodhimet e hartës linguistike dhe të popullatës muhamedane të Kosovës simbas statistikës jugosllave të vitit 1921.

Midis akteve ndodhen edhe disa lista me emrat e katundetve shqiptare të disa krahinave iredente.

Simbas vendimit të Komisionit Zoti Hamit Kokalari është porositur që të mbledhë librat dhe dokumentat që kanë me ardhë prej burime të ndryshme dhe t'a vazhdojë punimin duke bërë kërkimet e duhura dhe duke klasifikuar dokumentat simbas interesit që do të kenë dhe me kohë t'a paraqesë asaj së ndershmes Kryesije.

Me nderime
R. Fico. d.v.

NË FOTO:
(Nga e majta në të djathtë) Dhimitër Berati, Tahir Shtylla dhe Mustafë Kruja

qipërisë tek Gjiri i Artës, nga pikpamja gjeofizike është një rrip toke që lidhet natyrshëm me Shqipërinë, duke formuar së bashku me të një tërësi të njëtrajtshme orografike dhe ujore. Shqipëria dhe Epiri plotësohen ndërmjet tyre edhe përsa i përket natyrës së njëjtë të terrenit dhe prodhimit ekonomik.


2 – Etnikisht Epiri i përket Shqipërisë e jo Greqisë për motivet që pasojnë :

a) Nga dëshmi të njëzëshme të autorëve grekë del në shesh se, në lashtësi, Epiri ishte i populluar nga gjindje ilirike e, në çdo rasë, jo greke. Në Mesjetë, si në kohët moderne nën sundimin otoman, popullsia ilire, epirote e shqiptare mbizotëron e pakundërshtuar në Epir, duke përbërë elementin kryesor etnik.

b) Sasia m'e madhe e popullsisë ka qënë, deri në shekullin XIX, nga ana e popullit shqiptar e jo nga ana e atij grek. Kështu shpesh herë ka patur mërgime në masë të popullsisë shqiptare t'Epirit drejt Greqisë, të cilët, të filluar në shekullin e XI vazhduan deri në të XVI-in. Disa nga këta mërgime patën nxitjen e vetë princërve grekë, si ata të Teodorit I Paleologu, që tërhoqi në Greqi 10.000 familje shqiptare. Vetëm mbas fitores së pavarësisë së saj, në fillim të shek. XIX, Greqia filloi, nëpërmjet kishës e shkollës një politikë aktive depërtimelesh e asimilimesh në trojet fqinjë, si në Epir. Kjo u lejua, siç e kemi parë, nga qeveria otomane dhe u përkrah nga Patriarkana e Konstantinopolit. Kështu shpjegohet prania e elementit grek n'Epir edhe para 1912-ës.

c) Etnografikisht Epiri lidhet me Shqipërinë, sepse mënyra e jetesës e shumicës së banorëve të tij, shqiptarë dhe vllahë, traditat e tyre, zakonet ashtu sikurse formimi trupor paraqesin një afërsi të madhe me popullsitë toske të Shqipërisë.

3) – Nga pikpamja historike e politike Epiri nuk që kurrë grek, marrëdhëniet e tij me Greqinë nuk jana shumë të shpeshta në lashtësi. Kur fiset epirote marrin pjesë në lidhje, aleanca ose luftëra, gjithmonë quhen e konsiderohen jo grekë. Rrjeshtimet politike mesjetare të Epirit kanë të huaj, grek,serb, bullgar, bizantin ose perëndimor vetëm prirësin ose princin ; masa e popullit puntor e luftëtar është gjithmonë elementi vendas shqiptar. Nga gjiri i këtij elementi dalin më pas krerët që ndërtojnë më pas formacione shtetërore të rëndësishme si Shpatajt, Loshajt, Topiajt, Muzakët. Heroi kombëtar Shqiptar, Skënderbeu, mbante titullin "Mbret i epirotëve", mbasi në Mesjetë Shqiptarët përkufizoheshin me emrin Epirotë. Nën sundimin otoman të



ARTISTET
 Artistë që marrin pjesë janë në këtë ekspozitë janë Endri Dani, Helidon Gjergji, Alban Hajdinaj, Edi Hila, Ardian Isufi, Ilir Kaso, Olson Lamaj, Armando Lulaj, Violana Murataj, Matilda Odobashi etj

Punimet shqiptare në ekspozitën e Ludwig Museum Budapest

Kosova dhe Shqipëria rrëfejnë artin pamor

Dy skena artistike në kontekstin e Ballkanit prezantohen përmes punëve të 25 artistëve

DHURATA HAMZAI
TIRANE

Dy qëndrime artistike të fuqishme dhe emocionuese. Dy skena artistike, kulturore, sociale dhe politike në kontekstin e Ballkanit prezantohen përmes punëve të 25 artistëve në një ekspozitë që hapet për herë të parë këtë të martë në Hungari. Ekspozita e çelur në Ludwig Museum - muzeun e artit bashkëkohor të Budapestit ka në fokus prodhimtarinë dhe qëndrimet artistike të 10-15 viteve të fundit në Kosovë dhe Shqipëri. Ekspozita është konceptuar si dialogim mes skenave artistike të dy vendeve që flasin të njëjtën gjuhë, që

shpesh konvergjojnë në pika të përbashkëta por jo rrallë kanë pikëpamje të ndryshme. Programi i ekspozitës së Ludwig Museum Budapest-Museum of Contemporary Art, vendos një theks të fortë mbi aspiratat e reja artistike brenda rajonit, fenomenet përcaktuese dhe mediet e reja të artit. Artistë që marrin pjesë janë në këtë ekspozitë janë Endri Dani, Helidon Gjergji, Alban Hajdinaj, Edi Hila, Ardian Isufi, Ilir Kaso, Olson Lamaj, Armando Lulaj, Violana Murataj, Matilda Odobashi, Adrian Paci, Remijon Pronja, Anri Sala, Gentian Shkurti dhe Fani Zguro janë artistët nga Shqipëria. Bashkë me artistë shqiptarë do të kesp[ozojnë edhe keta ariste nga Kosova nga Kosova: Jakup Ferri, Flaka

Ekspozita
 ka në fokus prodhimtarinë dhe qëndrimet artistike të 10-15 viteve të fundit në Kosovë dhe Shqipëri

Haliti, "Haveit", Majlinda Hoxha, Genc Kadriu, Koja, Dren Maliqi, Alban Muja, Driton Selmani dhe Sislej Xhafa. E iniciuar në 2014 si rezultat i dialogut mes Galerisë Kombëtare të arteve në Tiranë dhe Ludwig Museum të Budapestit me të njëjtin koncept erdhi dhe

arti hungareze një muajin e kaluar në galerinë Kombëtare të arteve. Ekspozita e artistëve shqiptarë është publikuar edhe në faqen zyrtare të Ludwig Museum Budapest-Museum of Contemporary Art. Ludwig Museum - Museum of Contemporary Art, Budapest koleksionon dhe shfaq kryevepra të artit modern dhe bashkëkohor. Koleksioni permanent përmban vepra me vlerë të pop artit amerikan (Andy Warhol, Claes Oldenburg, Robert Rauschenberg, dhe të tjera). Në të njëjtën kohë fokusohet në artin e Evropës Qendrore dhe Lindore, duke u fokusuar veçanërisht në prezantimin e artit hungarez prej viteve '60 deri në ditët e sotshme në një kontekst ndërkombëtar.

Edicioni i 14-të

Nis Festivali i Butrintit çelet me shfaqjen nga Shqipëria

Shfaqja shqiptare "Made in Albania" me autor Stefan Çapaliku dhe regjisor Altin Bashën hapi dje natën e parë të festivalit Ndërkombëtar të Teatrit në Butrint. Edicioni i 14-të i këtij festivali do të mbahet nga datat 19 deri më 23 korrik në Teatrin e Qytetit Antik të Butrintit në qytetin turistik të Sarandës. Në skenën e këtij festivali në natën e dytë do të jepet një shfaqje koncertore me 60 artistë grekë nga Korfuza, të drejtuar nga dirigjenti me famë botërore Alkis Baltas. Ditët në vijim në skenën e këtij festivali do të shfaqet "Shtëpia

e Bernarda Albës", e regjisores Diana Dobra prezantohet nga trupa e Sofjas. Kjo është shpallur si shfaqja më e mirë e vitit 2015 në Bullgari. Nuk do të mungojnë në këtë festival edhe teatri spanjoll që do performojë në shfaqjen "Dasma e Gjakut" të Federico Garcia Lorckës me regji të Irina Kuberskaja. Trupa e Teatrit të Madrindit e ka realizuar këtë shfaqje posaçërisht për Festivalin e Butrintit, pohon drejtori i festivalit Alfred Bualoti. Festivali i Butrintit mbështetet nga Ministria e Kulturës, Bashkia e Sarandës dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit.



Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Drejtësia/ Lu: Kush nuk voton pasoja të rënda nga SHBA-të
- Gjermani, afgani plagos 4 persona me sëpatë në tren, vritet nga policia
- /Ja si u grabit nga maskat Banka në Vlorë
- Meta: Negociata të hapura me PD për dy pikat e ngërçit
- Si u kap mat e u filmua burri i gjyqtarës duke marrë eurot
- Zef Brozi-deputetëve të opozitës: Votoni për Shqipërinë jo për Salinë
- Meta: Rama më konstruktivi të enjten miratojmë reformën
- Sherr në PD,deputetët kryqëzojnë Bashën: Të votojmë reformën
- Vuçiq: Me shqiptarët do të jetojmë edhe 1000 vjet, nuk duam luftë
- Amnistia, falen detyrimet e mjeteve që s'kanë paguar taksa nga viti 2011

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Rama: Aleanca jonë do të votojë në bllok të enjten pro reformës
- Drejtësia/ Lu: Kush nuk voton pasoja të rënda nga SHBA-të
- "Drejtësia",Selami: Vota ime PRO edhe nëse PD është kundër
- Meta: Negociata të hapura me PD për dy pikat e ngërçit
- Sherr në PD,deputetët kryqëzojnë Bashën: Të votojmë reformën

VIDEOET MË TË KLIKUARA DJE

LSI kryebashkiakëve: Jo udhëtime jashtë vendit, s'ka pushime verore

Si u kap mat e u filmua burri i gjyqtarës duke marrë eurot


Korrupsioni i gjyqtarës, Gjykata lë në burg Petraq Dashin e Ilir Çabirin

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZH I DITES

A jeni dakord me deklaratën e Metës, se pas reformës vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme?

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:


Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampioneve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



2.451 | 236.035
 KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE

TERRORISTI


17-vjeçari që plagosi 4 në Gjermani, i lidhur me ISIS



Katër persona kanë mbetur të plagosur rëndë pas një sulmi nga një me sëpatë në trenin e linjës Würzburg-Heidingsfeld, raportojnë mediat gjermane. Fillimisht u raportua se kanë qenë rreth 20 persona të plagosur, por pas qetësimit të situatës është qartësuar gjithçka. Një zëdhënës i policisë gjermane ka bërë të ditur se autori i kësaj ngjarjeje u qëllua për vdekje nga forcat e policisë ndërsa po përpiqej të largohej. Pak orë më pas u konfirmua se agresori ka qenë një 17-vjeçar afgan, i cili para disa kohësh kishte mbërritur në Gjermani i vetëm dhe jetonte në kampin e Ochsenfurt. Edhe pse për momentin nuk mund të pohohet me siguri radikalizimi i tij, adoleshenti afgan, përgjegjës për episodin që tronditi mbërmbjen e djeshme opinionin publik gjerman duket të ketë qenë i frymëzuar nga ideologjia ekstremiste. Në dhomën e 17-vjeçarit, autoritetet gjetën një flamur të Shtetit Islamik, e sipas njërit prej dëshmitarëve në trenin e kthyer në skenë horror, i riu gjatë goditjes së disa personave me thikë e sëpatë, ka thirrur "Allahu Akbar". Agjencia e lajmeve Amaq, e lidhur me ISIS-in, pretendon se i riu ishte luftëtar i grupit xhihadist. Adoleshenti jetonte në qytetin fqinjë të Ochsenfurt dhe në Gjermani kishte hyrë si minoren e pashoqëruar nga prindërit.

Dallga e shkarkimeve në Turqi ka vazhduar me pëzullimin e 15.200 arsimtarëve të dyshuar për lidhje me klerikun Fetullah Gulen. Bordi i Arsimit të Lartë ka urdhëruar gjithashtu largimin e 1.500 dekanëve, e raportuar kjo nga media shtetërore, që citon burime pranë Ministrisë së Arsimit. Pak përpara këtij vendimi, kryeministri Binali Yıldırım ishte zotuar t'i zhduke nga rrënjët mbështetësit e dijetarit islamik, që jeton prej vitesh në mërgim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ish-aleati i Recep Tayyip Erdoganit mohon çdo përfshirje, por akuzat e përfshirjes së tij në grushtin e dështuar të shtetit kanë qenë të hapura. Përpara se fshesa e autoriteteve turke të binte mbi arsimin, shënjestra e saj u bë ushtria dhe policia, ku u shkarkuan e arrestuan me mijëra vetë. Në ndëshkimin e komplotistëve, presidenti turk duket i gatshëm të rikthejë deri edhe dënimin me vdekje, pavarësisht parajlmërimëve të prera të ndërkombëtarëve. "Turqia është një shtet demokratik i drejtuar nga sundimi i ligjit", i tha Erdogan turmës së simpatizantëve të mbledhur përpara rezidencës së tij në Stamboll. "Unë jam i gatshëm ta vendos sërish këtë dënim, nëse populli e kërkon dhe Parlamenti e miraton legjislacionin". "Nuk mund të bëhet veshi shurdh përpara kërkesave të popullit. A mos vallë Amerika vet nuk e ka dënimin me vdekje? Apo Rusia? Apo Kina? Apo shtete të tjera anembanë botës? Të vetmet që nuk e kanë dënimin kapital janë vendet e Bashkimit Europian", tha Erdogan. Turqia e hoqi në vitin 2004 dënimin me vdekje, në vazhdim e përpjekjeve të saj për t'u bërë pjesë e Bashkimit Europian.

GULEN
Ankaraja i ka dërguar Uashingtonit dosjen ku pretendon se ka prova të mjaftueshme ku vërtetohet përfshirja e imamit Fetullah Gulen në përgatitjen e grushtit të Shtetit dhe ku kërkohet ekstradimi i tij



Fetullah Gulen



Binali Yıldırım

"Fshesa", hiqen arsimtarë, dekanë e zyrtarë nga puna

Erdogan: Në rast se kërkon populli, e vendosim sërish dënimin me vdekje

Kundërshtari Rreziqet

Ankaraja i ka dërguar Uashingtonit dosjen ku pretendon se ka prova të mjaftueshme ku vërtetohet përfshirja e imamit Fetullah Gulen në përgatitjen e grushtit të Shtetit dhe ku kërkohet ekstradimi i tij

lah Gulen në përgatitjen e grushtit të Shtetit dhe ku kërkohet ekstradimi i tij. Sipas Turqisë imami i cili jeton në azil në Pensilvani është regjisor i vërtetë i pucit dhe prej vitesh ka pasur të infiltruar në ushtri. Në një intervistë për CNN Erdogan u shpreh se ka shpëtuar për mrekulli pasi nëse do të qëndronte 15 minuta më shumë në Marmara-


Sipas Moody's, Turqia vazhdon të operojë në një mjedis të brishtë financiar dhe gjeopolitik dhe cenueshmëritë nga jashtë po rriten, gjë që tregon për daljet e kapitalit nga vendi, rënie të rezervave

ris do të kapej dhe do të vritej. **EKONOMIA**
Ministri i Financave, Naci Agbal, premtoi se ekonomia do t'u mbijetojë goditjeve afatshkurtër që mund të vijnë si pasojë e grushtit të shtetit të javës së kaluar, ndërsa u përpoq të bindë investitorët të mos shesin zotërimet e tyre në tregun 718 miliardë dol-

larësh. Investitorët, nën panik, e quan bursën e Stambollit në rënie 7.1%, më të madhen në 3 vite. Banka amerikane e investimeve Goldman Sachs paralajmëroi se lira do të zhvlerësohej në 3.1 kundrejt dollarit brenda 3 muajve, ndërsa Fitch Ratings deklaroi se reagimi i Erdogan ndaj ndodhisë së fundjavës mund të dobësojë aftësinë kredituese sovranë dhe pengojë reformat strukturore. Sipas Moody's, Turqia vazhdon të operojë në një mjedis të brishtë financiar dhe gjeopolitik dhe cenueshmëritë nga jashtë po rriten, gjë që tregon për daljet e kapitalit nga vendi, rënie të rezervave dhe në skenarin më të keq, një rënie të bilancit të pagesave. Agbal hodhi poshtë dyshimet se e ardhmja e afërt politike e Turqisë është e paqëndrueshme, duke thënë se investitorët duhet të shohin reagimin e partive politike të Turqisë kundër grushtit të shtetit.

ZBULIMI


Kufiri i Kosovës me Malin e Zi ka qenë përcaktuar nga NATO



Në Kosovë është kthyer në çështje tepër të rëndësishme, që mban peng edhe liberalizimin e vizave për qytetarët kosovarë që duan të udhëtojnë lirshëm në vendet e zonës "Schengen" të Bashkimit Europian. Megjithatë debati për demarkacionin, i cili ka futur në një krizë politike palët pozitë-opozitë në Kosovë, duket se me shumë gjasa rezulton të jetë i kotë. Kështu të paktën lë të kuptohet një dokument i zbuluar nga "Gazeta Fjala" në vendin përtej kufirit, dokument sipas të cilit vija kufitare mes Kosovës dhe Malit të Zi është përcaktuar nga forcat shumëkombëshe të NATO-s. "Gazeta Fjala" ka zbuluar se demarkacioni mes Kosovës e Malit të Zi është konfirmuar në marrëveshjen e Kumanovës, me të cilën është dhënë fund pranisë së forcave të armatosura serbe në Kosovë. Në përcaktimin e kësaj vije kufitare mësohet të jetë marrë si e dhënë gjendja e kufirit të vitit 1988. E sipas asaj që bëhet e ditur, bazuar në këtë marrëveshje i jepet e drejta Komisionit shtetëror për Demarkacionin dhe përmbys pretendimet e tjera mbi mundësinë e humbjes së rreth 8 mijë hektarëve tokë. Në mesin 3 të kësaj marrëveshjeje përcaktohet qartësisht zona 5-kilometërsh, në të cilën nuk lejohet prania e forcave të armatosura të ish-Jugosllavisë, pjesë e së cilës ka qenë edhe Mali i Zi. Kjo zonë prej 5 kilometrash, e njohur si Zona e Sigurisë Tokësore, sipas këtyre dokumenteve fillon nga territori i Kosovës deri në pikën e Çakorrit. "Zona e Sigurisë Tokësore (GSZ) është përcaktuar si një zonë prej 5 kilometrash, që shtrihet përtej kufirit të Kosovës në territorin e pjesës tjetër të Republikës Federale të Jugosllavisë", thuhet në pikën 3 (e) të Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake.

SKANDALI/ MË PËRPARA E KISHTE MBAJTUR MICHELLE OBAMA

Zgjedhjet në SHBA, gruaja e Trump kopjon fjalimin



Melania Trump

Bashkëshortja e Donald Trump tërhoqi dritat e prozhektorëve mbërmbjen në Ohajo, ku përgjatë një jave do të shtrohen çështje të ndryshme që shqetësojnë amerikanët dhe propozimet për zgjidhjen e tyre sipas këndvështrimit të figurave të rëndësishme të kësaj partie. Në fjalimin e parë të rëndësishëm të saj, Melania Trump, e cila thuhet të ketë punuar me një profesion-

ist, u fokusua tek ajo që e cilësoi "fushata e pagjase" e bashkëshortit të saj. Ai është i ashpër atëherë kur duhet, por edhe i dashur e kujdesshëm dhe ndonëse mirësinë nuk e shpreh gjithmonë, është aty për sytë e të gjithëve. Kjo është dhe një nga arsytet përse unë rashë në dashuri me të, tha bashkëshortja e miliarderit Njujorkez, fjalimi i së cilës, i mbushur me nota personale, ra në kontrast me të tjerët që u përqendruan në lajtmotivin: "ta

bëjmë Amerikën përsëri të sigurt". Por ish-modelja slovene u akuzua shumë shpejt për plagjiaturë. Analistët vunë re disa ngjashmëri mes pohimeve të saj dhe një fjalimi të mëhershëm të zonjës së parë, Michelle Obama. Përpara nisjes se Kuvendit republikan, barrikada policie ishin vendosur në rrugët kryesore dhe kryqëzime në qendër të Clevelandit, për të parandaluar sulme të ngjashme me atë të Nice-s në Francë.

Partizani në kërkim të kualifikimit me Ferencvaros

Të kuqtë luajnë sot orën 19.30, në Budapest, shanset për të vazhduar aventurën europiane

Partizani, sot në orën 19.30, luan në Budapest shanset për të vazhduar aventurën europiane. Pas barazimit 1-1 të ndeshjes së parë në Elbasan, dueli ndërmjet të kuqve dhe Ferencvaros pritet të jetë mjaft i luftuar. Rezultati favorizon lehtësisht hungarezët, të cilëve do t'iu mjaftonte edhe barazimi pa gola për t'iu kualifikuar. Megjithatë, Partizani është një skuadër që nuk mund të nënvlerësohet. Të kuqtë nuk e njohin humbjen në aventurën europiane në këtë sezon, sepse kanë barazuar edhe në ndeshjen e mëparshme të luajtur në Europa League ndaj Sllovan Bratislavës. Pas përfshirjes në Champions dhe paraqitjes në Elbasan Arena, të besuarit e Adolfo Sormanit kanë fituar besim. Nënkompanët e Shqipërisë synojnë surprizën dhe i kanë

të gjitha kartat në rregull. Duke nisur nga fakti që janë një skuadër e fort në mbrojtje. Garancia e golave të paktë të pësuar, e shoqëruar me shfrytëzimin e shanseve të paraqitura, bëjnë që kalimi i turit të mos duket një utopi. Kjo edhe për faktin se megjithë historinë e madhe, Ferencvarosi nuk është një skuadër e frikshme. Me titullin kampion të Hungarisë të fituar pas 12 sezoneve dhe të rikthyer në Champions prej edicionit 2004-2005 kur kaluan Tiranën, ecuria e tyre e fundit në sfidat ndërkombëtare nuk është entuziazmuese. Në tre sezonet e fundit kur ka luajtur në Europa League, Ferencvaros është eliminuar gjithmonë në turin e dytë, me kundërshtarë dukshëm më inferiorë. Partizani duket se beson të mrekullia, edhe pse për t'ia dalë duhet të thejë një tabu, fushën në Gruopama Arena, aty ku



FAVORITI
Rezultati favorizon lehtësisht hungarezët, të cilëve do t'iu mjaftonte edhe barazimi pa gola për t'iu kualifikuar.

TRAJNERI
Thomas Doll e bëri të qartë se skuadra do të luajë në kërkim të golit pa llogaritur se edhe një barazim i bardhë e kualifikon

skuadra e drejtuar nga Thomas Doll është e pamposhtur prej 10 Shkurtit të kaluar, ku ka regjistruar nëntë rezultate pozitive.

DOLL: VETËM PËR FITORE

Ferencvarosh nis vetëm për fitore përballë Partizanit. Trajneri i skuadrës hungareze, Thomas Doll në konferencën tradicionale të shtypit para ndeshjes së kthimit të raundit të dytë eliminator në Champions League e bëri të qartë se skuadra do të luajë në kërkim të golit pa llogaritur se edhe një

barazim i bardhë e kualifikon, gjithsesi pa harruar të predikojë kujdes nga kundërsulmet e të kuqve. "Jemi në një pozicion të mirë dhe do të bëjmë gjithçka për të kaluar. Në fundjavën e kaluar u rikthyem te sukcesi pasi mposhtëm Haladas në javën e parë të kampionatit dhe shpresojmë që të vazhdojmë kështu. Ne nuk mund të luajmë për 0-0, kjo mund të na ndëshkonte shumë lehtë. Ne duam të shënojmë gola dhe mezi presim të luajmë. Lojtarët do të jenë më të freskët dhe me më shumë besim. Duhet të tregohemi të kujdesshëm për të mos bërë gabime naive sic bëmë në ndeshjen e parë. Duhet të luftojmë fort dhe të jemi të uritur për lavdi. Do të tregohemi inteligjentë dhe jo të gjithë lojtarët duhet të vrapojnë përpara, pasi duhet të jemi të përgatitur edhe për kundërsulmet e tyre".

Partizani është një skuadër që nuk mund të nënvlerësohet. Të kuqtë nuk e njohin humbjen në aventurën europiane në këtë sezon

MERKATO/ MINO RAIOLA FILLON BISEDIMET NË ANGLI

Manchester United gati 120 milionë euro për Pogba

Mesfushori 23-vjeçar do të nënshkruajë një marrëveshje 5-vjeçare, me një shpërblim që përlloragitet në 240 mijë €

Manchester United është në prag të gjetjes së akordit për finalizimin e transferimit që do të jetë një rekord botëror, nëse Pogba do të largohet nga Juventus për te Manchester United për shumën prej 125 milionë euro. Ekskluzivisht "SunSport" zbulon faktin se tratativat mes klubit të Juventusit dhe menaxherit të Paul Pogba, Mino Raiola, pritet

të finalizohen gjatë fundjavës. Paul Pogba parashikohet të hedhë firmën e tij mbi kontratën 5-vjeçare me Manchester United, menjëherë pasi të kthehet nga pushimet që po kalon në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Mesfushori 23-vjeçar do të nënshkruajë një marrëveshje 5-vjeçare, me një shpërblim që përlloragitet në 240 mijë euro në javë, ndërkohë


që Juventusit do të përfitojë plot 125 milionë euro në këmbim të futbollistit. Mino Raiola i ka kaluar ditët e fundit në bisedime me shefin e Manchester United, në lidhje me termat personal të futbollistit të përfaqësueses franceze, për një transferim që do të ekliposjë kështu transferimin 100 milionësh që Real Madrid pagoi për Gareth Bale në vitin 2013. Konkretisht, Pogba mund të udhëtojë drejt Manchester-it që ditën e martë, për t'iu nënshtruar vizitave mjekësore. Negociatat kanë qenë të komplikuar për faktin se Raiola ka një marrëveshje me Juventusin, sipas të cilit ai dhe lojtari francez do të përveçtojnë 25% të shumës së transferimit.

VIZITAT
Pogba mund të udhëtojë drejt Manchester-it që ditën e martë, për t'iu nënshtruar vizitave mjekësore



DY TIFOZET

Rike dhe Irid: Falë nesh bota njohu një Shqipëri tjetër



"Falë nesh bota njohu një tjetër Shqipëri", kështu janë shprehur dy tifozët që janë cilësuar si mbretëresha të këtij Kampionat Europian që sapo lamë pas. Rike Roçi dhe Irid Oxa në një intervistë për prestigjiozen "Corriere De La" janë shprehur së falë tyre bota ka njohur një Shqipëri tjetër me njerëz të bukur. Gjatë intervistës shqiptarja Rike e cila banon prej vitesh në Itali tha se Shqipëria është vërtet një vend i vogël por me vajza dhe djem shumë të bukur. Rike Roçi dhe Irid Oxa pushtuan faqet e mediave ndërkombëtare në ndeshjen Francë-Shqipëri, teksa ndodheshin në shkallët e stadiumit në mbështetje të kombëtares shqiptare.



Sekuestrohen 13 mln \$

Bastet për Euro 2016, mbi 4 mijë persona të arrestuar

Mbi 4 mijë persona të arrestuar, 13 milionë dollarë të sekuestruar dhe 3400 pika bastesh të jashtëligjshme që mendohet se kanë qarkulluar 6.4 miliardë dollarë në ndeshjet e ndryshme janë mbyllur. Ky është bilanci i operacionit të Interpol në luftën kundër vendosjes së basteve të paligjshme gjatë zhvillimit të Kampionatit Europian 2016 në Francë, që u mbyll pak ditë më parë, por edhe sporteve të

tjera. Qendra e basteve të paligjshme është Azia ku janë luajtur shuma të mëdha parash për ndeshjet e Euro 2016. Operacioni i Interpol është zhvilluar në Kinë, Francë, Greqi, Itali, Malajzi, Singapor, Tailandë, Vietnam, Kambodhia, Kore e Jugut dhe Filipine. Këto lloj bastesh prodhohen të ardhura për rrjetet kriminale, të cilat janë të lidhura me korrupsionin, trafikun e njerëzve njëzëre apo pastrimin e parave.

FJALËKRYQESH

NGA Kadri VOKOPOLA



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 34 KUTI

12x17 grid for the word search puzzle.

HORIZONTAL

- 1. Eshhtë vend nisjeje. -Cana i futbollit. -Gjysmë fasule. 2. Një zonë e kufizuar. -Organizata Sociale Lokale. 3. Behen për të mirë të tilla. -Kush nuk di... mbytet. -Qe mbreti jetëgjatë i Pilos. 4. Kryeqyteti i Perusë. -Janë fetarë. 5. Një pjesë e laikëve. -Mund të jetë i armatosur. 6. Film i Roberti Altman. 7. Përdoret edhe si izolet termik. -Ritet pa ekstreme. 8. -Kodra në një rrugë të Tiranës. -Mbyllin një manastir. -Llezet pa kufji. -Fillojnë udhëtimin. -Iqlli Tare. 9. Lidhin brigje. -Burton regjisor. -Mund të jenë djajmore. 10. Eshhtë material për qiri. -Ka kryeqytet Bamako. -Kilmer aktor. 11. Eshhtë enestetik. -Eshhtë e lehtë në meeling. -Fillojnë nesër. 12. Mund të jenë fetare. -Ishin mongolë e Tiumurlungut. -Në krye të krye të ekspeditës.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

Word search grid with words like KATEGORIK, URURIA, PANIK, etc.

VERTIKAL

- 1. Mund të jetë silikate. -Një parashitës për mbi. 2. Mund të jetë filmi. -Keshu thirrej Marco Pantani. 3. Eshhtë i mirë në shokë shumë. -Janë varur në stacion. 4. Mund të jetë vrastare. -Rrettojnë ringu n të tilla. 5. Një pjesë e redukimit. -Krap kur nuk ka -Gjysmë fitore.

- 6. Markë pistolette -Qe më burracaku i akejve 7. Tiriac ish-ish as i tenisist. -Janë vende për ekspozim. 8. Eshhtë automë. -Hari spiuane. 9. Janë të trajtuar me ujë e sapun. -Ekstreme në litar. 10. Të parat në orkestër. -Behen me hamendje. 11. Kidman aktore. -Ai dhe ajo. 12. Eshhtë princ arab. -Behzhan aktor. 13. Janë edhe ato të prodhimt. -Janë orarët e vetme 14. Janë strehat e barnijve. -Iniciale e Diderot. -Mbyllin fushatat. 15. Eshhtë ar. -Të parat në evidencë. 16. Mbarojnë fare. -Ishin gjigantët si Hiperionit. 17. Kanë shtretër për të pamundur -Monedha jonë.

FJALËKRYQI SPORTIV

12x12 grid for the sports crossword puzzle.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

Word search grid for sports crossword.

HORIZONTAL

- 1. Cirkuiti i Belgjikës. 4. Qe përfaqësuesja e Lewandowski-t. 11. Iniciale e Cere aktor. 13. Keshu kërcente Kledeta Gjini. 15. Eshhtë vija e portës. 18. Tevez bomber. 19. Eshhtë X në skedinë. 21. Mbyllin një koment. 23. Një derby i... Madoninas. 25. Njësimi pajanuar i futbollit tanë. 28. Janë me numër ato të futbollistëve. 30. Të parat në largim. 31. Janë të larta në vit ndeshje dramatike.

- 32. Eshhtë lloj papagalli. 33. Fund janari. 34. ... Kun Agüero. 37. Fillojnë reformën. 39. Në radhë të parë. 40. Personazhi në foto. 46. Personazhi në foto. 47. Eshhtë yll i skuadrës

VERTIKAL

- 2. Një mund të jetë fotografik. 3. Përfaqësohet nga Seleçao. 5. Iniciale e Stone regjisor. 6. Lëvizje Ekologjike Civile. 7. Shearer ish-bomber. 8. Mund të jenë kredit. 9. Perla pa kufji. 10. Kanë kors për gara. 12. Eshhtë ujë mineral. 14. Në hyrje të tokës. 15. Një fjalë gratis. 16. Gjysmë lëndem. 17. Entë Mjedisore Tiranë. 19. Një pjesë e bilancit. 20. Difronz në dietë. 22. Valeria showgirl. 23. Fillojnë metodat. 24. Mbyllin një sherr. 26. Louis Malie. 27. Kastile janë në fund. 28. Njësi matëse kondensatorësh. 29. Fillojnë natën. 34. Entë Rajonale Gramsh. 35. Beenhakker trainer. 36. Ferdinand mbrojtës anglez. 37. Një pjesë e realitetit. 43. Nina Simone. 39. Rastis përgjysmë. 41. Fillojnë detyrat. 42. Sean Connery. 43. Nina Simone. 44. Në fund të vitit. 45. Fillojnë takimin.

SUDOKU

PLOTESONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1-9

9x9 Sudoku grid.

9x9 Sudoku grid.

HOROSKOPI

DASHI: Dielli do ndërtojë në mëngjes jetën tuaj në çift sot, por pas mesditë retë do fillojnë të dalin dhe ambienti do ftohet. Kujdes me çdo gjë që do thoni. Beqaret do kenë një ditë shumë të paqëndrueshme dhe nuk do kenë as kohe të mendojnë për dashurinë. Ne planin financiar situata nuk do jete ashtu si keni dëshiruar. Kujdes me çdo shpenzim që do kryeni.

DEMI: Do ndërtoni një lidhje të qëndrueshme sot ju të dashuruarit dhe do filloni seriozitet të bëni plan për të ardhmen. Nuk do mbani aspak mendjen tek e shkuara. Beqaret do e kenë serisht të vështirë ta gjejnë personin ideal dhe do vazhdojnë të mbeten te vetmuar. Të ardhurat do i menaxhoni me shume përkujdesje e maturi kështu që gjendja do vije dalëngadalë duke u përmirësuar.

BINJAKËT: Çiftet që kane disa kohe që janë bashke do kenë një rikthim të pasionit gjate kësaj dite dhe emocionet do shtohen. Do flasin edhe për tema delicate me njëri-tjetrin, por pa arritur në debate. Beqaret ka mundësi të takojnë sot një person vërtet me vlera. Financat do fillojnë të stabilizohet disi për shkak të transaksioneve të kujdesshme që do kryeni.

GAFORRJA: Jeta juaj në çift do jete goxha e mire gjate kësaj dite. Nuk do e lini asnjë cast pas dore partnerin dhe do kaloni momente fantastike pranë tij. Beqaret do e shfrytëzojnë në pafundësi lirinë e tyre dhe do filtojnë me cilindo që do ju pëlqejë. Lidhje nuk do ketë, por do ndihen mjaft mire. Me shpenzimet tregohuni te logjiksëm dhe nuk keni për të pasur vështirësi.

LUANI: Ata që janë në një lidhje nuk duhet në asnjë mënyrë të marrin vendime të nxitura gjate kësaj dite sepse mund të kenë probleme serioze. Beqaret do fillojnë një aventura të shkurtër, por njëjtë pasionante dhe elektrizuese. Do ndihen mjaft mire. Ne planin financiar do jeni me fat dhe do keni mjaftueshëm të ardhura edhe për të shpenzuar edhe për t'i hequr mënjë. Në shpenzuar edhe për t'i hequr mënjë.

VRIGJËRËSHA: Urani do ndikojë negativisht sot tek jeta juaj në çift dhe mund të lindin probleme të njëpasnjëshme mes jush dhe partnerit. Të dy do mendoni se keni të drejte dhe nuk do e uini mundësi. Beqaret do jete romantike dhe ka mundësi të bëjnë për vete disa persona njëherësh. Financat do jete të favorizuara gjithashtu dhe nuk do keni asnjë tronditje.

PESHORJA: Në jetën tuaj në çift ka për të ndodhur një revolucion i vërtetë sot. Gjithçka do ndryshojë rrënjësisht dhe do ndiheni shumë me të qete se me pare. Beqaret do fillojnë aventura kalimtare të cilat do sjellin emociione, por do zgjatin shume pak. Ne planin financiar gjendja do jete e mire, pasi disa të afërmi do i japin mbështetje e tyre. Pranjojeni pa u menduar dy here.

AKREPI: Dite e begate do jete kjo e sotmja për të gjithë ata që janë në një lidhje. Do merreni vesh me se miri me partnerin dhe kënaqësitë do jete të njëpasnjëshme. Beqaret nuk do jete ende gati për të filluar një lidhje dhe nuk do pranojnë asnjë ftesë që do ju behet. Buxheti nuk do jete aspak ashtu si keni dashur. Kujdes me çdo hap që do hidhni sepse mund të mbeten pa para.

SHIGJETARI: Duhet të tregoheni diplomatë sot ju të dashuruarit dhe nuk duhet kursesi të hidhni hapa të nxitura. Silluni mirë me atë që keni në krah. Beqaret do kenë një ditë plot ngjyra dhe do zgëtohen jashtë mese. Ata duhet ta shfrytëzojnë këtë mundësi për t'u afruar me ata që pëlqejnë. Për financat do përkujdeseni më tepër dhe gjendja do mbetet e kënaqshme.

BRICJAPI: Dite jo e mire do jete kjo e sotmja për të dashuruarit. Nuk do ju pëlqejë sjellja e partnerit dhe mund të debatojeni ashpër me të. Beqaret do jete ëndërrimtare të mëdhenj dhe do zgëtohen pa mese nga realiteti. Nuk do jete ditë e tyre me fat. Ne planin financiar fati do jete gjithë kohës me ju dhe nuk do keni asgjë për çfarë të qaheni. Mund të hiqni edhe para mënjë.

UJORI: Nuk duhet absolutisht të qëndroni në qetësi sot ju të dashuruarit dhe ta lini rutinën t'u pushtojë sepse nuk do dilni dot prej saj. Beqaret do kenë mundësi reale për të filluar lidhje serioze dhe afatgjate. Shume gjera do ndryshojnë në jetën e tyre. Financat do vazhdojnë të mbeten te mira sepse keni ditur si t'i menaxhoni të ardhurat që keni neper duar.

PESHQIT: Dite shume e qete ka për të qene kjo e sotmja për ata që janë në një lidhje. Do flasin lirshëm me partnerin tuaj dhe do i sqaroni te gjitha mosmarrëveshjet. Beqaret nuk do preferojnë të bëjnë ndryshime te statusit dhe do mbeten ashtu si janë. Ne planin financiar do ju dalin vështirësi goxha të mëdha. Po nuk morët shpejt masa dhe ta ndryshoni situatën do keni probleme akoma me serioze.

PËRGJIGJE

Word search grid for the horoscope section.

SHKRONJA ENJËTË PËR NUMËR TË NJËTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

12x12 grid for the cryptogram puzzle.

Surpriza e Sezonit Turistik 2016

NA VIZITONI



BUNK'ART

Ekspozita video-muzeale brenda ish-bunkerit anti-bërthamor
të ushtrisë shqiptare



www.bunkart.al / info@bunkart.al

Prenotime:

+355 (0) 67 20 72 905



Rr. Fadil Deliu
(afër teleferikut)
Tiranë - Albania

